



Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale

Akademia për Qeverisje Lokale Gjenerata e Dytë

This Program is supported by the Friedrich Ebert Foundation and Norwegian Embassy



Përmbajtja

I.	Modulet e trajnimit	3
II.	Moduli i Parë	6
III.	Prezantimi i Hulumtimit “Kryetari Komunës - Përfaqësues apo Dominues ?”	10
IV.	Moduli i Dytë	13
4.1.	Historiku i Qeverisjes Lokale në Kosovë – Raportet në mes Nivelit Politik dhe Administratës ...	13
V.	Vizita studimore në Republikën e Maqedonisë.....	18
VI.	Moduli i Tretë	21
6.1	Raportet në mes Nivelit Qendror dhe Nivelit Lokal	21
VII.	Vizita studimore në Republikën e Shqipërisë	23
VIII.	Moduli i Katërt.....	31
8.1.	Bashkëpunimi ndër-komunale dhe roli i asociacioneve	31
IX.	Moduli i Pestë Temat sektoriale	33
X.	Konsultim me Kryetarët e Komunave.....	36
XI.	Vizita studimore në Republikën e Malit të Zi dhe Kroacisë	37
	Reformat në Republikën e Malit të Zi dhe Kroacisë	37
	Moduli i Pestë Temat sektoriale	40
XII.	Themelimi i komunave të reja: mundësi apo pengesë për shërbime më të mira në sistemin e qeverisjes lokale.....	40

Akademia për Qeverisje Lokale

“Akademia për Qeverisje Lokale” - AQL është trajnim i ndërtuar mbi përvojën, njohuritë dhe ekspertizën pesëvjeçare të Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale – IQL. Gjatë kësaj periudhe, IQL ka zbatuar me sukses projekte të natyrës vlerësuese, hulumtuese dhe trajnuese. Konkretisht, si pikë reference IQL ka pasur dhe do të ketë, në njërin anë, legjislacionin dhe politikat që rregullojnë qeverisjen lokale, ndërsa, në anën tjetër, kapacitetet institucionale dhe vendimmarrjen. Kështu, në mënyrë aktive IQL kërkon shtigje në të cilat mund të intervenohet nëpërmes iniciativave që forcojnë nivelin e qeverisjes lokale.

Nga sa u tha, AQL, nëpërmes moduleve trajnuese të cilat janë ofruar përmes ligjëratave, diskutimeve, punës në grupe dhe platformës për shkëmbim të përvojave dhe informacionit, është fokusuar në elaborimin dhe kristalizimin e konceptit modern të qeverisjes lokale në Evropë dhe rajon. Kjo i ka ndihmuar pjesëmarrësit në module, që të investojnë në avancimin e konceptit të qeverisjes lokale. AQL ka ofruar mundësi krahasimi midis modeleve të ndryshme të qeverisjes lokale, nga demokracitë e konsoliduara dhe ato në rajon. Në këtë mënyrë, trajnimi i ka kontribuar elaborimit dhe analizimit të atyre attributeve dhe karakteristikave të modeleve të tjera, të cilat do të mund të shfrytëzoheshin dhe akomodoheshin në modelin e qeverisjes lokale në Kosovë.

AQL, në mënyrë kritike, por konstruktive, është marrë me shtjellimin, interpretimin dhe analizimin e politikave dhe legjislacionit që rregullon qeverisjen lokale në Kosovë. Si rezultat, pjesëmarrësit në këtë trajnim kanë pasur mundësi që, si nivel i veçantë i qeverisjes, kundrejt qeverisjes qendrore, të jenë ata të cilët dalin në mbrojtje, në promovim dhe avancim të këtij niveli. Adresimi i çështjeve legjislative dhe politikave, do t’ua mundësojë zyrtarëve dhe aktorëve të tjerë në nivel lokal që të mund t’i përdorin njohuritë dhe shkathtësitë e marra nga trajnimi, konform nevojave për adresimin e vështirësive dhe gjetjen e zgjidhjeve në proceset e qeverisjes.

AQL, në procesin e ofrimit të moduleve ka ofruar material mbi apskte të demokratizimit, përfshirjes dhe kohezionit social. Në esencë, kjo përshkon qeverisjen nëpërmes informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe akterëve në nivel lokal dhe më gjerë. Në këtë aspekt, trajnimi ndikon në konsolidimin demokratik në nivel lokal, por edhe në forcimin e lidhjes midis strukturave të zgjedhura/qeverisëse dhe të përfaqësuarve/qytetarëve. Në qeverisje demokratike parashih praktika dhe procese, të cilat sigurojnë që strukturat qeveritare nuk shkëputen nga vullneti, shqetësimet dhe pritjet qytetare.

AQL, përmes këtij programi, që për synim ka ngritjen e kapaciteteve të përgjithshme, ka për qëllim, veçanërisht, që t’i fuqizojë asambleistët e gjashtë komunave. Vlerësimet që dalin nga puna disavevjeçare e IQL-së, tregojnë se asambletë komunale nuk janë duke e ushtruar fuqishëm funksionin mbikëqyrës dhe monitorues ndaj fuqive zakonisht të mëdha dhe me tendencë në rritje të ekzekutivit dhe, veçanërisht, kryetarit. Para së gjithash, AQL ka për synim që të ngrisë bashkëveprimin dhe komunikimin midis këtyre akterëve kyç të qeverisjes dhe të demokracisë lokale në nivel komunal. AQL, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit, rrjetëzimit dhe të vëzhgimit të drejtpërdrejtë në fushën e qeverisjes lokale në rajon, ka organizuar dhe punëtori në rajon.

Konkretisht dhe, në veçanti, programi AQL është dizajnuar nga profesionistë të fushës dhe personalitete me eksperiencë. Si i tillë, ky program ka trajtuar tema që në thelb shtrojnë nevojën për intervenim dhe përmirësim të gjendjes në fushën e qeverisjes lokale në terren. Mes tjerash, temat e programit kanë adresuar: 1. Parimet e Demokratizimit dhe ndërlidhjen me Decentralizimin; 2. Sistemin e Decentralizimit dhe Menaxhimin; 3. Konceptet e qeverisjes së mirë - ofrimit dhe shërbimeve komunale efikase; 4. Administratën Publike dhe parimet e saj; 5. Informimin, transparencën dhe llogaridhënien; 6. Rëndësinë e planifikimit buxhetor; 7. Komunitat v.s. Integrimin Evropian; 8. Përfshirjen qytetare - vendimmarrjen me pjesëmarrje; 9. Rolin e shoqërisë civile dhe të medias; 10. Bashkëpunimin ndërkomunal; 10. Barazinë dhe fuqizimin gjinor. AQL është një program fleksibil, por në rritje e sipër. Në një të ardhme, programi ka për qëllim të mbulojë të gjitha komunitetet e Kosovës

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Komuna	Pozita
1	Jashar Dobraj	Deçan	Kryesues i Asamblesë
2	Musa Mushkolaj	Deçan	Këshilltar Komunal
3	Agron Demukaj	Deçan	Drejtor për Buxhet e Financa
4	Zoje Selmonaj	Deçan	Zyrtare e Shpenzimeve-Kontabilitet
5	Ajne Iberhysaj	Deçan	Inspektore për Mbrojtje të Ambientit
6	Shyqri Krasniqi	Fushë Kosovë	Drejtor i Auditimit të Brendshëm
7	Ejup Qyqalla	Fushë Kosovë	Shef për Shërbime Publike dhe Emergjencia
8	Bardhyl Kojçiçi	Fushë Kosovë	Shef në Drejtorinë për Ekonomi
9	Fitore Hykaj	Fushë Kosovë	Këshilltare Komunale
10	Lindita Dervisholli	Fushë Kosovë	Zyrtare për Barazi Gjinore
11	Enver Mavriqi	Kamenicë	Kryesues i Kuvendit Komunal
12	Jeton Biqkaj	Kamenicë	Këshilltar Komunal
13	Enver Ajvazi	Kamenicë	Drejtor i Administratës dhe Personelit
14	Kimete Kryeziu	Kamenicë	Udhëheqëse e Shërbimit Social QPS
15	Merita Agaj	Kamenicë	Këshilltare Komunale
16	Sami Morina	Kamenicë	Udhëheqës i Personelit
17	Refik Halili	Klllokot	Nënkryetar
18	Skënder Hoda	Klllokot	Drejtor i Administratës
19	Musa Preteni	Mitrovicë	Parlamenti Studentor
20	Nemanja Kokerić	Mitrovicë	Drejtor për Arsim, Rini, Kulturë dhe Sport
21	Aleksandar Marković	Mitrovicë	Drejtor për financa dhe Zhvillim ekonomik
22	Hamit Mripa	Mitrovicë	Zyrtar i Lartë Ligjor
23	Zoran Djokić	Mitrovicë	Drejtor për Financa dhe zhvillim Ekonomik
24	Dibran Perçuku	Vushtrri	Nënkryetar i Komunës
25	Sami Istrefi	Vushtrri	Drejtor i Shërbimeve Publike
26	Naim Hyseni	Vushtrri	Drejtor i Emergjencave
27	Vlora Qirezi	Vushtrri	Këshilltare Komunale
28	Bahrije Pllana	Vushtrri	Këshilltare Komunale
29	Arta Ismajli	Vushtrri	Këshilltare Komunale
30	Vjollca Behluli	Prishtinë	DEMI
31	Ramadan Gashi	Prishtinë	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
32	Safete Greicevcin	Prishtinë	Zyra e kryeministrit për Komunitete
33	Sadije Jashari	Mitrovicë	Zyra për Integritet Evropiane
34	Ajshe Bërveniku	Prishtinë	Zyra për Integritet Evropiane
35	Luljeta Bërveniku	Prishtinë	GIZ
36	Linda Daija	Prishtinë	Asociacioni i Komunave të Kosovës

I. Modulet e trajnimit

- **Moduli i parë**
 - **Demokratizimi dhe Decentralizimi**
- **Moduli i dytë**
 - **Historiku i Qeverisjes Lokale në Kosovë – Raportet në mes Nivelit Politik dhe Administratës**
- **Moduli i tretë**
 - **Raportet në mes Nivelit Qendror dhe Nivelit Lokal**
- **Moduli i katërt**
 - **Bashkëpunimi ndër-komunale dhe roli i asociacioneve**
- **Moduli i pestë**
 - **Temat sektoriale**

Vizitat Studimore

- **Vizita studimore në Republikën e Maqedonisë**
- **Vizita studimore në Republikën e Shqipërisë**
- **Vizitë studimore në Republikën e Malit të Zi dhe Kroacisë**

II. Moduli i Parë

2.1. Hapja e Akademisë

2.2. Demokratizimi dhe Decentralizimi

Vendi: Hotel Harmonia, Republika e Shqipërisë

Data: 1-4 Nëntor 2012

Ligjëruesit:

Prof. Neritan Sejmini, Magjistër i Shkencave nga Universiteti George Washington University, Washington DC dhe ish-këshilltar i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë

Erion Veliaj, Magjistër i Shkencave nga Universiteti i Sussex, UK
Ish-themeluesi i lëvizjes MJAFT dhe ish-drejtuari i G-99 |

Besnik Tahiri, Magjistër i Shkencave të Qeverisjes së Decentralizuar dhe Zhvillimit Ndërkombëtar

Besnik Osmani, Magjistër i Shkencave – Universiteti Amerikan i Kosovës, Sekretar i Ministrisë së Pushtetit lokal

Fatmir Haxholli, Magjistër i Studimeve Bashkëkohore Evropiane

Agron Maxhuni, Drejtor Ligjor Ministria e Pushtetit Lokal

Temat:

- **Decentralizimi në aspekti historik, akademik, studimor - Konteksti Ndërkombëtar i Qeverisjes Lokale dhe Zhvillimit të pushtetit Lokal**
- **Konceptet Themelore të Decentralizimit: Devolimi, Dekoncentrimi dhe Decentralizimi Administrativ – Parimet e Rondinelit**
- **Demokratizimi në raport me Decentralizimin – Rasti i Kosovës - Prezantimi i Publikimeve të Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale**

Publikimet



- Teoria e Zgjedhjes Publike - Qeverisja, Institucionet dhe Demokracia
- Demokracia dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve në shoqëri - Shoqëria Civile, Institucionet dhe Partitë Politike
- Shtet-ndërtimi në raport me Decentralizimin - Rasti i Republikës së Kosovës
- Organizimi dhe funksionimi i Pushtetit Lokal në Kosovë - Baza Ligjore e organizimit dhe funksionimit

Reformat në Pushtetin Lokal parakusht për Integrimi Evropiane



Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale organizoi ceremoninë solemne me rastin hapjes zyrtare të Akademisë për Qeverisje Lokale – Gjenerata e Dytë. Ceremonia dhe hapja u mbajtën në Golem të Republikës së Shqipërisë, nga data 01 – 04 nëntor, 2012.

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale nëpërmes Akademisë për Qeverisje Lokale është duke ofruar një program edukativ të mirëfilltë dhe substancial në fushën e qeverisjes lokale në Kosovë. Të nominuarit nga pesë komuna (Kamenicë, Vushtrri, Deçan, Kllokot dhe Fushë Kosovë) përbëjnë gjeneratën e dytë të këtij programi, ndërsa mesin e tyre janë edhe një numër zyrtarësh nga zyra administrative e Mitrovicës së Veriut. Niveli i përfaqësimit përfshinë zyrtar të lartë komunal (nënkryetarë dhe drejtor) si dhe kryetar të Kuvendeve Komunale.

Drejtori Ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale, z. Besnik Tahiri në hapjen e programit theksoj se janë 4 elemente kyçe në të cilat bazohet programi: 1. Të gjeturat nga hulumtime dhe puna periodike e KLGI-së; 2. Vlerësimi i nevojave për ngritje të kapaciteteve të komunave; 3. Përkrahja metodologjike dhe profesionale e Universitetit të Birminghamit; dhe 4. ekspozetë e ligjëruesve ndërkombëtar, vendor dhe rajonal. Kjo sipas z. Tahiri do të mundësoj ndërthurjen e praktikave rajonale, teorive ndërkombëtare lidhur me pushtetin lokal dhe me zhvillimet aktuale, përfshire edhe nevojat aktuale që ka Kosova.

Z. Tahiri duke elaboruar teorinë ‘Konceptet teorike të Decentralizimit theksoi se para se një shoqëri të shtyj politikë e decentralizimit, duhet të kemi së paku tri parakushte për të:

I pari i referohet shkallës së lartë të kapacitetit qendror të shtetit. Për shkak se zbatimi efektiv i decentralizimit kërkon koordinimin ndërmjet niveleve dhe kërkon më shumë rregullore për ta garantuar transparencën themelore, llogaridhënien dhe; një shtet i dobët nuk mund të zbatojë decentralizimin në mënyrë të suksesshme. Kërkesa e dytë është një shoqëri civile e zhvilluar mirë. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për aspektin pjesëmarrës, por edhe për shkak se do të mund të ofronte burime shtesë për informim e komenteve si dhe kritika konstruktive për pushtetin lokal. I treti është një projekt politik në të cilin një forcë e organizuar politike përkrah decentralizimin dhe siguron zbatimin e tij. Po ashtu nuk duhet të harrojmë se qeverisja efektive lokale varet nga burimet e ekzistuese, të cilat janë adekuate dhe të qëndrueshme .



Profesori Neritan Sejamina në prezantimin e tij mbi “Teorinë e Zgjedhjes Publike” shpjegoi rolin e kësaj teorie në analizimin dhe studimin e proceseve dhe aktorëve politik, si dhe rëndësinë e saj për të bërë zgjedhjet e politikave të duhura në interes të publikut (moralisht, ekonomikisht), dhe përmirësimin e anës organizative (menaxhimi i informacionit dhe strukturës). Duke analizuar nocionin ‘Qeverisje e Mirë, Prof. Sejamina theksoi se ka ende shumë punë për tu bërë për të arritur tek një qeverisje e mirë me një transparencë dhe llogaridhënie të qartë.

Në një tematike tjetër, z. Erion Veliaj në prezantimin e tij “demokracia dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve në shoqëri” elaboroi rolin e shoqërive aktive në raport me mekanizmat institucional, për shtytjen e proceseve dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Ai po ashtu u shpreh se shpesh mungon vizioni tek institucionet, por ai duhet të vijë nga aktorë tjerë duke qenë aktiv në politik-bërje dhe vendim-marrje.

Gjatë këtij moduli u diskutua mbi temën e shtet ndërtimit në raport me decentralizimin. Në këtë temë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal u përqendrua në elaborimin e dimensioneve të: Organizimit dhe Funksionimit të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës; dhe Roli i Komunave në procesin e Integritimit evropian.

Akademia për Qeverisje Lokale do të vazhdojë punimet me sesionin e radhës të paraparë të mbahet në fund të muajit nëntor. Përshtypja e përgjithshme në mesin e pjesëmarrësve në AQL ishte se ky program do të ndihmojë përmirësimin e qeverisjes lokale në përgjithësi, si dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale në veçanti.



III. Prezantimi i Hulumtimit “Kryetari Komunës - Përfaqësues apo Dominues ?”

Vendi: Hotel Grand

Data: 7 nëntor 2012

Referuesit

Slobodan Petrović, Zëvendës-Kryeministër dhe Ministër i Administratës së Pushtetit Lokal

Besnik Tahiri, Magjistër i Shkencave të Qeverisjes së Decentralizuar dhe Zhvillimit Ndërkombëtar

Menduh Vlashi, Kryesues i Kuvendit Komunal – Hani i Elezit

Besa Luzha, Përfaqësuese e FES-it

Fatmir Matoshi, Drejtor i OJQ “D-Press”

Leonora Kryeziu, Drejtoreshë e Shkollës Politike të Prishtinës

Temat

- **Reforma e Qeverisjes Lokale dhe Decentralizimi në Kosovë – *institucionet e ndryshme, pikëpamjet e ndryshme?***
- **Llogaridhënia në Qeverisjen Lokale - Kryetari Komunës - Përfaqësues apo Dominues**
- **Trekëndëshi në Pushtetin Lokal: Kryetar (ekzekutiv) - kuvend komunal (legjislativ) – qytetar (shoqëri civile) - Perspektiva komunale**

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale rekomandon rishqyrtimin e pagave për delegatët e Asambleve Komunale në mënyrë që të rritet kualiteti i punës së Kuvendeve. KLGJ paralajmëron degradim dhe mosinteresim të ekspertëve të ndryshëm për të garuar për Asamble nëse ata sanksionohen me ligj për të punuar me pagesat aktuale vetëm si asamblistë. Prishtinë, 07 nëntor, 2012 - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale mbajti konferencë vjetore ku u prezantua studimi me titull “Kryetari Komunës - Përfaqësues apo Dominues?”.



Ky publikim analizon baraspeshën institucionale të institucionit të Kryetarit kundrejt Kuvendit Komunal dhe Ekzekutivit, si dhe marrëdhëniet e Kryetarit të Komunës me akterë lokal dhe qytetarë.

Në fjalën hyrëse, Zv. Kryeministri i Republikë së Kosovës, z. Slobodal Petrović, falënderoi Institutin Kosovar për Qeverisje Lokale për angazhimin e vazhdueshëm në fushën e pushtetit lokal, dhe po ashtu ju referua zhvillimeve në fushën e qeverisje lokale katër vite pas nxjerrjes së

Kushtetutës. Z. Petrovic theksoi se, qëkur ka filluar procesi i decentralizimit janë shënuar hapa të rëndësishëm duke sjellë shërbime më efikase për qytetarët, dhe se ky proces duhet te vazhdoj.

Për këtë qëllim sipas z. Petrovic duhet marr në konsideratë rekomandimet që dalin nga institute të ndryshme dhe të shoqërisë civile dhe akterë tjerë në këtë proces.

Z. Besnik Tahiri, Drejtor i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale, theksoi se, ‘Konstatimi i themelor i këtij publikimi është se roli i institucionit të kryetarit në sistemin e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës shtron nevojën për më shumë kontroll, baraspeshë dhe mbi të gjitha llogaridhënie të brendshme institucionale, si dhe kundrejt publikut”.

Z. Tahiri elaboroi që publikimi argumenton se për shkak të rolit shumë të fuqishëm të institucionit të kryetarit në njërin anë, dhe në anën tjetër rolit pasiv të Kuvendit Komunal, i kombinuar me apatinë qytetare rezulton me shfaqjen e një deficitit demokratik shumë shqetësues për zhvillimet e qeverisjes lokale tani, dhe në të ardhmen.

Sipas z. Tahiri, në esencë publikimi synon të qartësojë pozicionimin e institucionit të kryetarit si institucion kyç në trekëndëshin, kryetar (ekzekutiv) - kuvend komunal (legjislativ) - qytetar (shoqërisë civile).



Konferenca u karakterizua nga debati interaktiv mes zyrtareve të komunave, përfaqësuesve të shoqërisë civile, dhe pjesëmarrësve të tjerë. Po ashtu në konferencë u prezantuan edhe perspektiva e komunave dhe shoqërisë civile në këtë proces për raportet e Kuvendeve Komunale (legjislativit) në raport me Kryetarin e Komunës (egzekutivit).

Drejtuksi i organizatës D-Press, z. Fatmir Matoshi, theksoi se, “në rast se vëzhgohet kujdesshëm fuqia e Kryetarit kundrejt Kuvendit Komunal, dhe veçanërisht në rast se analizojmë marrëdhëniet e këtij institucioni me qytetarë do të ishim dëshmitar të koncentrimit të pushtetit në këtë adresë”.

Dhe ky realitet, sipas z. Matoshi, do të duhej ndryshuar sepse po shohim keq-menaxhim të mjeteve financiare, po shohim keq-ekzekutim të mandatit, dhe po shohim qytetarin e zhveshur nga ndikimi. z. Matoshi përmendi nevojën për ndryshime legislative, si dhe për vendosjen e praktikave të qarta të llogaridhënies në kuadër të institucioneve, si dhe në marrëdhëniet e tyre me qytetarë.

Ndërkaq rekomandimet që dalin nga ky studim tregojnë se: kryetarët e komunave duhet të krijojnë platforma të qarta komunikimi me publikun e gjerë dhe qytetarët, në mënyrë që të sigurohet që politik-bërja në nivel komunal të jetë e përgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe transparente. Po ashtu, është domosdoshmëri që përpos komiteteve obligative komunale, kryetarët e komunave duhet të bëjnë përpjekje dhe të inkurajojnë themelimin e komisioneve sektoriale të Kuvendit në mënyrë që të rritet veprimi ndërmjet organeve komunale legislative dhe ekzekutive.

Është e domosdoshme që MAPL dhe Asociacioni i Komunave të iniciojnë ngritjen e të ardhurave për këshilltarët komunal, ndërkaq komunat duhet të sigurojnë hapësirat për veprim dhe mbështetje teknike duke përfshirë zyrat, dhe resurset tjera të mjaftueshme për funksionim.

Sa i përket përzgjedhjes së drejtorëve të drejtorive KLGJ rekomandon fuqishëm që të ndryshohet forma e zgjedhjes, duke kaluar nga emërimet në atë të përzgjedhjes përmes një procesi të hapur konkurrues (profesional dhe akademik) të bazuar në meritokraci dhe kritere të qarta. KLGJ po ashtu rekomandon që të krijohet linjë e veçantë buxhetore për organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të rritet pjesëmarrja aktive e tyre

IV. Moduli i Dytë

4.1. Historiku i Qeverisjes Lokale në Kosovë – Raportet në mes Nivelit Politik dhe Administratës

Vendi: Hotel Emerald

Data: 23 nëntor 2012

Ligjëruesit

Sadri Ferati, ish-Ministër i Pushtetit Lokal, tani Deputet dhe anëtar i komisionit parlamentar për Pushtet Lokal

Päivi Nikander, ish shefe e zyrës së ICO për decentralizim/Këshilltare e lartë Decentralizim – Qeverisje Lokale UNDP

Ardian Zeqiri, Drejtor i ECMI-së, ish OSBE-së në Kosovë. Ish-zyrtar për Demokratizim dhe Specialist i Mbështetjes për Qeverisje Lokale OSBE

Temat

- **Historiku i Reformës së Qeverisjes Lokale dhe Decentralizimit në Kosovës – Mundësitë dhe Sfidat**
- **Institucionalizimi i politikave për minoritete përbrenda qeverisë- ristrukturimin e qeverisjes lokale përmes decentralizimit.**
- **Parimet e Hapësirës Administrative Evropiane; strategjitë e reformë së administratës publike në Kosovë; elementet kyçe të proceseve reformuese në BE.**
- **Raporti në mes nivelit politik dhe administratës**

Sadri Ferati, ish-Ministër i Pushtetit Lokal, tani Deputet dhe anëtar i komisionit parlamentar për Pushtet Lokal

Ligjëruesi i lartpërmendur, theksoj se procesi i decentralizimit ka qene një sfide për Kosovën, i cili është konceptuar si një shkalle drejt ndarjes së Kosovës përgjatë vijave të përbërjes së saj demografike, ndër të tjera theksoj se si proces gjatë realizimit u keqkuptua nga opinioni, si synim që të kënaq vetëm nevojat dhe pritjet e komunitete jo shumice në komunat ku jetojnë. Decentralizimi ka qenë kryesisht politik nga lart poshtë i Bashkësisë Ndërkombëtare. Fillimisht ishte shpallur nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, atë të pas luftës se vitit 1999 (në Mitrovicë). Por një konsiderim serioz kishte marre vetëm pas negociatave për statusin e Kosovës të kryesuar nga Marti Ahtisari. Gjatë bisedimeve të statusit si dhe diskutimit të decentralizimit në nivelin më të lartë përfituesit dhe komunat nga ky proces nuk janë konsultuar. Decentralizimi në Kosove u përcjelle me sfida për arsye se ishte shumë i



qartë në letër, në praktike gjatë realizimit pati kundërshtime të shumta, u përcjelle me protesta e gjithë kjo kishte erdhe nga mungesa e informimit jo aq të duhur për opinionin për procesin decentralizimit, mungesa e punës të partive politike me elektoratin.

Ligjëruesi theksoj edhe rrugën e bisedimeve të grupit të kontaktit të mbajtura në Vjenë në prani të ndërkombëtareve. I njëjti theksoj se, komunat nga të cilat u ndanë dhe u formuan komunat e reja ku, këto kane qenë të pa përgatitura për kompetenca, mungese fondesh, për një administrim funksional duhet ofruar një plan strategjik, një strategji me vizion të qartë për veprim, një gjë e tillë komunave ju ka munguar. Zgjedhjet e lokale të mbajtura në vitin 2000 si hap i rëndësishëm në ndërtimin e pushtetit lokal, ndër të tjera ligjëruesi theksoj se shumica e programeve politike të kandidatëve për kryetar të komunave nuk kane pasur një strategji të mirëfilltë, cila do të posedonte brenda vetes plane konkrete strategjike për zhvillim lokal.

Ne këto programe politike kanë dominuar më shume projekte si prioritet për asfaltim të rrugëve. Ndërsa Besnik Tahiri në përmbledhje theksoj se, për një administrate efikase duhet ndërtuar vizion me plane pune me programe strategjike që në thelb kanë strategji zhvillimore për rritjen hyra vetanake të komunës.

Päivi Nikander, ish shefe e zyrës së ICO për decentralizim/Këshilltare e lartë Decentralizim – Qeverisje Lokale UNDP

Si pjesëmarrës gjatë bisedimeve për procesin e decentralizimit në Kosovë, theksoj pengesat që janë shfaqur rreth kalimit të kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, kjo së pari është dashtë të rregullohet me ligje se cilat kompetenca do të kalojnë tek komunat. E njëjta theksoj se ka qenë e domosdoshme të rregullohet me kornizën punuese legjislative, një gjë e tillë më së mire ka definuar Kushtetuta e Kosovës, po ashtu edhe ligjet që duhet të janë në harmoni me Kushtetutën. Ajo përmendin këto ligje si:

Ligji për kufijtë Administrative të Komunave

Ligji për Zgjedhjet Lokale

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjet sipas sektorëve

Gjithashtu, e njëjta theksoj edhe transferimin kompetencave se çka do të lëshoj niveli qendror në ato lokale po ashtu e domosdoshme ka qenë edhe përcaktimi i raporteve në mes komunave të reja me ato amë. E njëjta shpjegoj edhe për kompetencat vetanake këto përfshijnë 18 fusha, ne do të përmendim disa më të rëndësishme si: zhvillimi lokal ekonomik, planifikimi urban dhe rural, shfrytëzimi dhe zhvillimi i tokës, rregulloret dhe standardet e kontrollit në ndërtim, mbrojtja lokale e ambientit, shërbimet publike dhe komunale, përgjigje ndaj emergjencave në nivel lokal, shkollimi para fillor dhe i mesëm, shërbimet shëndetësore publik primar, mirëqenia sociale, strehimi publik, licencimi e pajisjeve dhe shërbimeve lokale si aktivitete kulturore dhe rekreacioni, ushqimi, tregjet, shitësit e rrugës, transporti lokal, emërimi i rrugëve, parqet publike, turizmi, kultura dhe shume të tjera.



Ne këto kompetenca komunat kanë fuqi të plote ekzekutive; por e njëjta theksoj se disa komunave ju rriten kompetencat sidomos ato komuna me shumice serbe do të kenë kompetenca vetanake të shtuara në fushat për shëndetësi, çështje arsimore dhe kulturore dhe do të kenë të drejtë pjesëmarrjen e zgjedhjes së komandanteve të stacioneve të policisë lokale por disa autoritet qendrore delegojnë kompetenca si regjistrat kadastrale, regjistrat civil, regjistrimi i votuesve regjistrimi dhe licencimi i bizneseve, shpërndarjen e pagesave të ndihmave sociale mbrojtjen e pyjeve.

Ligjëruesja theksoj se ky delegim i kompetencave pati ndikim pozitiv në rritjen e financave komunale, e cila prezantoi në mënyrë tabelave nga viti 2008-2012, ku të ardhurat nga burimet vetanake në vitin 2008 kanë qenë 49 % ndërsa në vitin 2012 kanë qenë 60 %. Gjithashtu e njëjta theksoj edhe sfidat që kane përcjellë procesin e formimit të komunave të reja me raport me komunat amë. Një gjë e tillë për tejkalim të pengesave për bartjen e dokumentacionit nga komunat amë është bërë në pajtim të ministrive relevante përmes nënshkrimit të përbashkët të Memorandumeve të Mirëkuptimit.

Sfida gjate përcjellës së kompetencave ajo theksoj se mungesa e debateve në nivel nacional mbi nivelin e duhur të kompetencave, përkufizim i paqartë i kompetencave, fondet jo të mjaftueshme për përcjellje të kompetencave, kapacitete ndryshuese të komunave për zbatimin e funksioneve, një bashkëpunim jo aq të mire nder-ministrore, pronësia dhe bashkëpunimi në lidhje me burimet natyrore dhe infrastrukture, pronësia e paqarte e pronës publike dhe procesi i ngadalshëm i privatizimit, procesi i ngadalshëm i administratës publike dhe gjyqësorit, tejkalimi i punësimit të shërbyesve civil që tejkalon lirinë komunale të punëtorëve etj.



Në fund theksoj se duhet të jepet një rendësi e madhe participimit të sektorit privat, partneriteti publiko-privat shumë i domosdoshëm ku përmendi si shembull kompanitë për administrim të mbeturinave, që janë kthyer në nivel lokal, ato të ujit janë gjysme pra regjionale akoma të pa definuar ashtu si duhet. Theksoj se për një rehabilitim paqësor atij të brendshmit pushteti në atë jashtëm duhet të ketë një strategji të përcjellur me vizion të qartë të veprimit (pagesat –taksat e pronës ëe duhet paguar, një sistem gjyqësor efikas si të gjendet çelësi që qytetari të ketë dëshirë për të paguar etj.)

Ardian Zeqiri, Drejtor i ECMI-së, ish OSBE-së në Kosovë. Ish-zyrtar për Demokratizim dhe Specialist i Mbështetjes për Qeverisje Lokale OSBE

I cili ndër të tjerat theksoj në prezantimin e tij duke dhënë shpjegimin definicionit se decentralizimi është transferim i pushtetit nga niveli qendror në një nivel më të ulte lokal/periferik të qeverisjes. Me qëllim të promovimit të qeverisjes së mire, zhvillim ekonomik, efikasitet në ofrimin e shërbimeve publike dhe të akomodoj interesat e grupeve/ komunitete divergjente.

Fushëveprimi i vetëqeverisjes lokale është parapare dhe ne Kartën e Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale, e cila kërkon që “përgjegjësitë publike përgjithësisht duhet te ushtrohen, sipas preferencës nga ato autoritete që janë më së afërmi me qytetarin. Gjatë ndarjes së përgjegjësisë ndonjë autoriteti tjetër duhet të matet masa dhe natyra e asaj detyre dhe kërkesat e efikasitetit dhe ekonomizimit”. Ky parim ndryshe njihet si parim i subsidiaritetit andaj sipas raportit të Kartës, cili është burim zyrtar paragrafi 3 neni 4 artikulon parimin e përgjithshëm sipas të cilit ushtrimi i përgjegjësisë publike duhet të decentralizohet. Karta i referohet përveç kompetencave vetanake po ashtu parshehë edhe kompetencat të deleguara, ku përfshinë të drejtën dhe mundësinë e autoritete lokale që brenda kufizimeve të ligjit, të rregullojnë dhe të menaxhojnë një pjesë substanciale të punëve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës lokale.

Ligjëruesi theksoj se Karta mbi Vetëqeverisjen Lokale (Karta) është miratuar në forme të një konvente nga Këshilli i Ministrave i Këshillit të Evropës, e njëjta është nënshkruar si konvente nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo Karte, e adaptuar nga Kongresi i Këshillit të Evropës me 1985. Kjo Karte është dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar që përcakton parimin e vetëqeverisjes lokale. Ratifikuar prej 44 nga 47 shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, duke përfshirë edhe të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian.

Ligjëruesi i lartpërmendur në prezantimin e tij te decentralizimi dhe minoritet në Evrope tha se nuk ka model që mbulon te gjitha interesat e grupeve divergjente ai përmendi si:

- Vet-qeverisja lokale
- Të drejtat speciale/të drejta shtesë
- Autonomi personale/kulturore
- Autonomi territoriale

Problemet e ndryshme p.sh. diskriminimi, seciosionismi, të drejtat kulturore, të drejtat fetare, të cilat realizohen në sisteme të ndryshme politike.

Ardian Zeqiri, theksoj edhe principet kryesore te Kartës si:

- principi i subsidiaritetit;
- Autoritet lokale të zgjedhura në mënyre demokratike ;
- Autoritet lokale kanë kompetenca, vetëm në rastet kur kjo kompetence ju merret në mënyre decidive dhe të shkruar nga niveli tjetër;
- Autoriteti lokale për aq sa është e mundur duhet të konsultohen dhe do të kenë ndikim në të gjitha politikat që prekin interesat e tyre;
- Autoritet lokale do të kenë kompetenca të gjera për sa i për ketë vendosjes se strukturave të brendshme të tyre;

- Mbikëqyrja, për sa i përket kompetencave të tyre, do të ketë vetëm formën e mbikëqyrjes legale dhe intervenimet mund të jenë vetëm proporcionale;
- Mbikëqyrja me e gjerë është e mundshme për sa i përket kompetencave të deleguara nga niveli qendror;
- Autoritetet lokale do të kenë të drejtën për resurse adekuate financiare, duke përfshirë edhe mbledhjen e taksave lokale;
- Autoritetet lokale do të kenë të drejtën për të lidhur në mes veti ;

E gjithë kjo ka për qëllim këto rezultate :

- Qeverisjen e mirë
- Demokratizimin
- Zhvillimin ekonomik
- Llogaridhënien
- Politika përgjegjëse
- Pjesëmarrje
- Përmirësim i shërbimeve

Tek pjesa e decentralizimit të komuniteteve theksoj se pronësi lokale. Lejon komunitet të komentojnë në politikat të cilat kanë ndikim në jetën e tyre. Mirëpo tek mbrojtja nga “diktatura e shumicës” theksoj atë; Mbrojtja nga fuqia e Qeverisë Qendrore;

- Ekonomia
- Etniciteti
- Fizike

Përmirësimi i pjesëmarrjes së minoriteve në proceset politike. Ligjëruesit, theksoj edhe rreziqet nga decentralizimi duke përmendur se:

- I forcon dhe legjitimon ndarjet etnike-pranimi i ndryshimeve etnike në të njëjtin sistem.
- Krijohen minoritet të reja-të drejtat e gjera të komuniteteve.
- Implikimet për sovranitetin e shtetit-mbikëqyrje qeveritare
- Komunitet e paqëndrueshme-principi i subsidiaritetit & decentralizimi fiskal

Një prej faktorëve vendimtarë të decentralizimit , u theksuan që duhet të jete vullneti politik, pjesëmarrja, principet subsidiaritetit, decentralizimi fiskal.

Ligjëruesi përmendi apo bëri një krahasim në rastin në Kosovë, në ndërtimin e gjithëmbarshtëm të shtetit-Kushtetuta që përcakton ne:

- Nenin 2. Republika e Kosovës është shtet i qytetareve të saj...
- Neni 3.1 Republika e Kosovës është një shoqëri multi-etnike..
- Neni 57. Komunitetet që i përkasin një grupi kombëtar, etnik, gjuhësor apo fetare dhe që janë tradicionalisht të pranishëm në Kosovë.

Të drejtat e posaçme dhe të drejtat shitesë së bashku me mekanizmin për mbrojtje të drejtave, Kushtetuta i përcakton në Nenin 5, përveç të drejtave dhe lirive themelore të parashtruara në kapitullin e dytë (II) të Kushtetutës.

Në fund ligjëruesi përmendi edhe strukturat e vetëqeverisjes lokale duke përmendur këto elemente:

- Ricaktimi i kufijve komunal: 90 % e komuniteteve pakicë që jetojnë në komunat ku ata janë shumicë;
- Devulvimi asimetric i pushtetit-kompetencat shitesë të komunave;
- Partneriteti në mes të komunave;
- Raportet speciale me Republikën e Serbisë;

V. Vizita studimore në Republikën e Maqedonisë

Vendi: Republika e Maqedonisë

Data: 26-28 dhjetor 2012

Tema:

- **Decentralizimi në Republikën e Maqedonisë**, mësimet e nxjerra nga ky proces

Ligjëruesit / Referuesit

Rizvan Sylejmani, Ish-ministër i Pushtetit Lokal në Maqedoni

Sadi Bexhetin, Kryetar i Komunës së Tetovës

Prof. Dr. Vullnet Ameti, Rektori i Universitetit të Tetovës

Prof. Dr. Zamir Dika, Rektor i Universitetit të Evropës Juglindore

z. Hazbi Idrizi, Kryetar i Komunës së Bogovinës

Prof. Dr. Rufi Osmani, Kryetar i Komunës së Gostivarit

Vizitat:

Vizitë Komunës së Tetovës; Vizitë Universitetit të Tetovës; Vizitë Universitetit të Evropës Juglindore; Vizitë Ndërmarrjes Publike; Vizitë Komunës së Bogovinës; Vizitë Komunës së Gostivarit.

Mbi vizitën studimore në Maqedoni të organizuar nga Akademia për Qeverisje Lokale

Në kuadër të modulit parë të Akademisë për Qeverisje lokale, është organizuar programi i vizitës studimore në Republikën e Maqedonisë nga data 26-28 dhjetor 2012.



Kjo vizitë për qëllim ka pasur të nxjerr mësimet dhe praktika të mira nga procesi i decentralizimit në Republikën e Maqedonisë, ku në këtë vizitë janë takuar kryetarët e Komunave të Tetovës, Gostivarit, Bogovinës, përfaqësues të jetës akademike në Universitetin e Evropës Juglindore dhe një takim jashtëzakonisht interesant me ish-Ministrin e Pushtetit Lokal Rizvan Sylejmanin.

Këtë vizitë e kanë përshkruar disa aktivitete siç janë: Takime të shumta me kryetarë dhe funksionar komunash ku për së afërmi është parë procesi i decentralizimit në Republikën e Maqedonisë dhe strukturimin e qeverisjes komunale po ashtu janë nxjerrë dallimet dhe ngjashmëri në organizimin e administratës komunale me Republikën e Kosovës, pothuajse në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Janë vizituar ndërmarrjen publike komunale në Tetovë, ku është vërejtur një model tjetër organizativ që dallon nga organizimi i ndërmarrjeve komunale në Kosovë. Kjo ndërmarrje i takojnë tipit konservativ të organizimit, ku të gjitha shërbimet komunale (ujësjellësi, kanalizimi, pastrimi, gjelbërimi janë të koncentruar në një ndërmarrje të vetëm) dhe me një trup qeverisës. Më këtë model qeverisjes të ndërmarrjes komunale për së afërmi është vërejtur që është jo funksional për fakti që ofrimi i shërbimeve për qytetarët nuk është në nivelin e duhur, është ekzistente një administratë ngarkuar zyrtarësh si dhe u vërejtur linjë jo adekuate e raportimit në nivele menaxheriale të ndërmarrjes në fjalë.



Nga të gjitha këto probleme Drejtori i Përgjithshëm paraqiti një pasqyrë jo të mirë të inkasimeve të të hyrave të cilat ishin shumë të vogla afërsisht 17% të hyrave të planifikuara vjetore. Po ashtu gjatë vizitës është parë qartë se decentralizimi nëpër komuna shqiptare kishte karakter diskriminues në veçanti në ndarjen e buxhetit vjetor nëpër komuna. Po ashtu shumë shërbime që realisht është dashur të barten në nivel komunash akoma janë në kompetencë të nivelit qendror të qeverisjes si p.sh leje ndërtimit, menaxhimi me prona komunale etj. Vizite brenda saj ka pasur dhe ligjërimin e mbajtur nga ish – Ministri i Pushtetit Lokal z.Rizvan Sylejmani, ku në fillim të ligjëratës së ti lidhur me procesin e decentralizimit në Republikën e Maqedonisë u shpreh se „Decentralizimi nuk është fat por zgjedhja jonë”, nga kjo më la të kuptoj se qytetarët në Republikën e Maqedonisë posaçërisht shqiptarët nuk e shohin decentralizimin si një proces të ofrimit të shërbimeve qytetarëve, por më shumë si imponim dhe ndarje territoriale të komunitetit.

Sipas Kartës Evropiane për decentralizim ekzistojnë dy tendenca që e shtynë një shtet për decentralizimin e pushtetit lokal:


- a. Decentralizimi shihet si një instrument për dhënien e shërbimeve të qytetarëve; dhe
- b. Decentralizimi si instrument politik-përfaqësimit të identitetit të bashkësisë (ku përfshihet elementi kulturorë dhe rritja e përfaqësuesve të komunitetit në vendimmarrje).

Mirëpo kjo nuk ka ndodhur në Maqedoni thekson ish ministri Prof. Rizvan Sylejmani, mirëpo decentralizimi në Maqedonisë ka ardhur si rezultat i presionit nga jashtë, e jo nga vlerësimi real i nevojës shtetërore për decentralizim të pushtetit.

Pas konfliktit të armatosur në Republikën e Maqedonisë në mes komunitetit shqiptare dhe atij Maqedonas janë bërë edhe hapet e para në krijimin e strategjisë për decentralizim ku si për qëllim ka pasur përafrimin ndaj konfliktit në njërin anë dhe në anën tjetër përmbushjen e qëllimeve politike, ku janë përfshirë- integrimin e pakicës shqiptare në Maqedoni dhe organizimin territorial të tyre theksoi profesor Rizvan Sylejmani.

Marrëveshja e Ohrit akoma me shumë specifikon se në Republikën e Maqedonisë decentralizimi për të qenë funksional duhet bazohet në dy parime kryesore dhe në pajtim të plotë me kartën evropiane: ofrimin e shërbimeve komunale me afër qytetarëve dhe parimin politik apo përfaqësues ku komuniteti shumicë merr vendim për territorin e caktuar, mirëpo ka ngecje të theksuar në zbatimin e plotë të kësaj marrëveshje thekson ish-ministri.

Sipas ligjit për qeverisje lokale dhe ligjit për ndarje territoriale në Republikën e Maqedonisë, ekzistojnë 124 komuna.



VI. Moduli i Tretë

6.1 Raportet në mes Nivelit Qendror dhe Nivelit Lokal

Vendi: Republika e Shqipërisë

Data: 12 shkurt 2013

Ligjëruesit:

Prof. Dr. Donald Curtis, Specialist i Manaxhmentit Publik dhe Zhvillimit Institucional

Prof. Arian Galdini, Magjistër i Shkenca Politike dhe Politikave Publike

Besnik Tahiri, Magjistër i Shkencave të Qeverisjes së Decentralizuar dhe Zhvillimit Ndërkombëtar

Temat:

- **Përgjegjësia dhe rreziku moral i qeverisë lokale – çështjet kyçe**
- **Llojet e Decentralizimit – Akomodimi i Diversitetit**
- **Kërkesa e ndarjes së pushtetit të shoqërive të pas luftës**
- **Qeveria Lokale dhe kompaktësia sociale**
- **Demokratizimi kundrejt Decentralizimit – Përse qeveritë apo qytetarët përkatës duhet të preokupohen me decentralizimin?**
- **Roli dhe rëndësia e politikave publike në qeverisjen lokale**

Prof. Dr. Donald Curtis, Specialist i Manaxhmentit Publik dhe Zhvillimit Institucional

Prof. Dr. Donald Curtis, theksoj se mira publike kombëtare shërbehet më së miri, atëherë kur e mira publike lokale përfaqësohet më së miri, pikërisht kësaj të mirë publike lokale është kur kjo rregullohet me kushtetute kombëtare, kjo kushtetute ti dhuroj kompetenca interesave lokale, duke krijuar sfera të ndara të qeverisjes, në këtë aspekt theksoj se interesat lokale dhe interesat kombëtare mund të përputhen ose ndonjëherë do të jenë në kundërshtim.

Pikërisht me atë qendra kërkon të mira universale, integritet territorial, mbajtjen e diversitetit, angazhimin qytetar për të mirën publike të gjerë, mirëpo komuna kërkon interesa të ndryshme specifik sa më shumë kompetenca, zë lokal dhe përfaqësim, ndarje të barabartë e burimeve kombëtare.



E mira publike i adresohet interesit të qytetarit për të ndërtuar ketë marrëdhënie të nivelit qendror dhe lokal, duhet krijuar disa nivele përgjegjës në interes të qytetarit, e cila duhet të jetë e rregulluar më marrëveshje dhe më ligj.

Në ligjërimin e tij theksoj bashkëpunimi ose partneriteti në mes nivelit qendror dhe lokal, për një lider ka rëndësi gjetja e gjuhës se përbashkët, e cila kërkon gatishmërinë për zgjidhje të çështjes, për ti dhënë dhe marrë negociatat deri në zgjidhje, po ashtu theksoj edhe mediat nuk janë gjithnjë miqësore apo të sinqerta lidhur për trajtimin e mosmarrëveshjeve qeveritare, p.sh. transporti lokal lidhur më atë kombëtar, zhvillim ekonomik, ndarja burimeve natyrore etj, në rast të jashtëzakonshëm të konstatuara përbrenda një kornize kushtetuese është esenciale për qeverisje të mirë.

Ajo që ka rëndësi për një lider të aftë është të kuptojnë Kushtetutën të njëj Ligjet dhe të përdor negociatat ku shkathtësia e secilit lider pastaj të pranohet nga partia dhe ndjekësit (elektorati) është besimi pikërisht për këtë udhëheqja politike nuk ka të bëjë vetëm me marrëdhëniet konstruktive (kushtetuese, ligjore) ndërqeveritare por edhe për fitimin e mbështetjes publike.

Prof. Arian Galdini, Magjistër i Shkenca Politike dhe Politikave Publike

Në ligjërimin e tij theksoj rëndësin e qytetarit në vendimmarrje. Këtë e potencoj për formimin e komisioneve të ankimimit ku qytetari i shpreh pakënaqësitë e tij për shërbime etj. Për investimet publikeje ndërhyrje te interesit publik dhe interesit real te publikut, këtë pushteti lokal duhet të shfrytëzoj më së shumti nëpërmjet zërit te qytetarit në përcjellim zërin



tonë.

VII. Vizita studimore në Republikën e Shqipërisë

Vendi: Republika e Shqipërisë

Data: 10-13 shkurt 2013

Tema:

- **Reformat në Republikën e Shqipërisë - Pushteti Lokal karshi sfidave dhe perspektivës së integrimit evropian**
- **Ligjeruesit / Referuesit**

Sokoll Olldashi, Ministër i Punëve Publike dhe Transportit

Sokol Dedja, Këshilltar i Ministres Majlinda Bregu

Lulzim Basha, Kryetar i Bashkisë së Tiranës

Xhelal Mziu, Kryetar i Bashkisë së Kamzës

Vizitat:

Vizitë ministrisë së Punëve Publike në Republikën e Shqipërisë; Vizitë ministrisë së Integrimit në Republikën e Shqipërisë; Vizitë Bashkisë së Tiranës;

Mbi vizitën studimore në Shqipëri të organizuar nga Akademia për Qeverisje Lokale

Në kuadër të modulit të Akademisë për Qeverisje lokale, është organizuar programi i vizitës studimore në Republikën e Shqipërisë nga data 10/13 shkurtë 2013. Kjo vizitë studimore ka për qëllim bashkëbisedimin me zyrtarë të qeverisjes lokale dhe qendrore, në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që të njoftohemi me zhvillimet dhe reformat që Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë përgjatë procesit të integritimit evropian.

Këtë vizitë e kanë përshkruar disa aktivitete siç janë:

- Takimin me Ministrin së Punëve Publike dhe Transportit, z. Sokoll Olldashi dhe stafin e tij, ku është diskutuar shumë çështje të funksionimit të kësaj ministrie e theks të veçantë është folur për formën e investimeve publike në Shqipëri, kriteret për ndarjen e fondeve dhe prioritete të kësaj ministrie për këtë vit fiskal në raport me pushtetin lokal Shqipëri;
- Vizitë Ministrisë së Integritimit, takimi me stafin e kësaj ministrie është diskutuar në lidhje me agjendën evropiane të Shqipërisë, nivelin e arritjes së Shqipërisë në plotësimin e kriterëve për inkuadrim në BE, dhe zyrtarët janë fokusuar në shpjegimin e procedurave të përfitimit të fondeve nga ana e BE-së;
- Vizitë Bashkisë së Tiranës, takim me Krye-bashkiakun z. Lulzim Basha dhe stafin e tij, ka qenë një diskutim i frytshëm ku z. Basha fillimisht shpjegoi një histori shkurte të Tiranës, po ashtu u koncentrua mbi potencialin ekonomik që ka ky qytet, mbi investimet që bëhen dhe mbi hyrat që inkasohen, besoj që ja vlen të shkoqitem një element nga ligjërata e tij, ku theksoj se mbi 42% e hyrave Tirana i realizon në nivel kombëtar.

Sokoll Olldashi, Ministër i Punëve Publike dhe Transportit

Ndërlidhja e nivelit qendror me atë lokal është në shume aspekte por ai me rëndësishëm është Komisioni i investimeve, përbehet nga kryetarët e bashkive, të qarkut, ministri i linjës etj. Zhvillimin e transportit në shkallë vendit (Shqipëri), e prezantoi Ministri Olldashi, i cili njoftoi të pranishmit se zhvillimin e transportit është një domosdoshmëri e kohës, ku shteti shqiptar ka dhënë prioritet të madhe përmirësimit të sistemit të transportit. Sistemit i transportit përbehet nga transporti rrugor, hekurudhor, detar, ajror.

I njëjti prezantoi edhe korridoret kryesore të transportit duke theksuar se Shqipëria nëpërmjet pozicionit gjeografik të saj përfshihet në disa korridore të transportit, për destinacionin e tyre për lëvizjen e mallrave, udhëtarëve apo për shërbime turistike, prej korridoreve kryesore theksoj si: Korridorin Lindje perëndim (korridor i VIII Pan Evropian- (Durrës –Tiranë); Vlorë-Rrogozhinë-Elbasan – Qafë Thanë etj.

Të pranishmit i njoftoi se rritje të konsiderueshme kanë sektorët e transportit ajror dhe ai rrugor, ky i fundit ka arritur nivelin rreth 85 %. Gjithashtu theksoj se transporti detar si një ndër sektorët më ekonomik të sistemit të transportit kryen pjesën më të madhe të shërbimeve për import-eksportin e mallrave për/nga vendi ynë dhe transite një rol të rëndësishëm ka edhe Porti Detar i Durrësit që zë peshën më të madhe rreth 78% të volumit të përgjithshëm pastaj ai Vlorës, i Shëngjinit, dhe Porti i Sarandës.

I njëjti theksoj se përpjekjet Shqipërisë për integrim në BE- si vend kandidat po punohet në të gjithë komponentë e transportit për kryerjen e reformave të gjithanshme në transport, përfshirë ato ekonomike, ligjore dhe institucionale mbështetur në studimet, projektet dhe asistencën e konsulentëve vendas dhe të huaj.

Po ashtu, theksoj investimet që po bënë qeveria në ndërtimin e një porti të specializuar për përpunimin e karburanteve dhe gazit të lëngshëm në Porto Romano, Rrugën Elbasanit, në Portin e Sarandës si arterien kryesore rrugore që lidh Hani i Hotit – Kakavijë etj.



Lulzim Basha, Kryetar i Bashkisë së Tiranës



Njoftoi të pranishmit rreth organizimit dhe funksionalizimit të Bashkisë së Tiranës, Tirana si kryeqytet i Shqipërisë u shpall nga Kongresi i Leshnjes. Bashkia e Tiranës vepron sipas ligjit Për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë së Tiranës, i cili parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë, këshillit bashkiak dhe 11 njësite bashkiake. Kryetari i Bashkisë theksoj se politikat e Bashkisë së Tiranës në planifikim dhe menaxhim synojnë në :

- Reduktimin e shpenzimeve të personelit;
- Reduktimin e shpenzimeve administrative në favor të fondeve për shërbime ndaj qytetarëve;
- Transparençë të plote të përdorimit të fondeve publike;
- Rritjen e efikasitetit në administrimin e fondeve;
- Rritjen e nivelit të investimeve
- Zhvillim ekonomik dhe punësim
- Strehimi dhe planifikimi

Kryetari i Bashkisë, theksoj se shpenzimet e personelit janë ulur ndjeshëm në krahasim me vitet e mëparshme. Nga një peshë prej 40%, në vitin 2010 dhe zënë 25% në vitin 2012. Në zhvillim të bizneseve, rëndësi i kishte dhënë krijimi klimës miqësore për bizneset vendase nëpërmjet thjeshtësimit të procedurave administrative, dhe ofrimit të sistemit online të aplikimit, po ashtu theksoj masat që janë marrë edhe për bizneset e huaja lehtësimi i procedurave duke përfshirë edhe krijimin mjedisit të sigurt për investim në Shqipëri me anë të reformave fiskale për konkurrencë të ndershme. Përveç mbështetjes së bizneseve nëpërmjet të programeve të kredive, prioritet ishte dhënë edhe reformave të partneritetit publiko-privat. Të hyrat më së shumti buxhetit të vendit krijon Bashkia e Tiranës rreth 80%, andaj me këto masa të ndërmarra do të krijohen kushte më të mira për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha. Bashkia e Tiranës një prioritet i kishte dhanë shtimit të sipërfaqeve publike, pastrimin të qytetit, investim programit për përmirësim i teknologjisë të shërbimeve publike janë nda mjete nga buxheti i Bashkisë Tiranës afërsisht 32%. Investimi në përmirësim të rrugëve dhe transport publike (një rëndësi të madhe i kishte dhënë transportit publik), investime në hapjen e akseve të reja rrugore të qytetit, të pikave hyrëse dhe dalje të tij, mbikalimeve dhe nënkalimeve, parkimeve nëntokësore, asfaltim i rrugëve, si dhe ngritjen e një sistemi të qarkullimit të menaxhimit të trafikut të monitoruar online. Gjithashtu, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, theksoj edhe projektin për ndërtim të Unazës së Madhe të Tiranës, një projekti që do të ketë ndikim të madhe në shkarkim të qendrës nga numri i madhe i makinave. I njëjti theksoj se, paraprakisht Ministria e Transportit ka bërë përllogaritjen e vlerës në para që do të kompensohet çdo person që do të prekën nga ky segment, shpronësimi kap shumë të madhe parash, u theksua se përveç këtyre investimeve kapitale përfshihen edhe investime në arsim parauniversitar dhe edukim (ndërtim i shkollave, kopshteve, rikonstrukcion), por vëmendje të veçantë Bashkia e Tiranës i kushton politikave sociale nëpërmjet tri programeve sociale të parashikuara më ligj. Kërkesat sipas programeve sociale përfshijnë kërkesë për banesë me kosto të ultë, banesa sociale më qira, tokë të pajisur me infrastrukturë. Investime për realizimin e projekteve për kulturë, rini dhe sport.



Sokol Dedja, Këshilltar i Ministres-Majlinda Bregu

Diskutimi i Sokol Dedja, u përqendruar në politiken Shqipërisë duke theksuar atë në raport me BE-në dhe plotësimin të kriterëve që dalin nga BE-ja për vend kandidat (administrativ, politik, juridik, ekonomik). Një rëndësi ju kushtuar edhe IPA-fondeve si bashkëpunimit ndërkuftar, një numër i madhe fondeve për bashkëpunim kishte fituar pjesa veriore e Shqipërisë, por deri më tani nuk kishin pasur një bashkëpunim me aspektin e bashkëpunimit ndërkuftar veçanërisht me Kosovën, ishin në realizim me Malin e Zi, Maqedoni në të ardhmen mbete të përfshihet edhe Kosova në një realizim të përbashkët.



Vendi: Hotel Emerald

Data: 15 shkurt 2013

Ligjeruesit:

Prof. Dr. Ita O'Donovan, ligjëruese në Universitetin e Birminghamit dhe njëherësh eksperte e Komisionit Evropian

Besnik Tahiri, Magjistër i Shkencave të Qeverisjes së Decentralizuar dhe Zhvillimit Ndërkombëtar

Fatmir Haxholli, Magjistër i Studimeve Bashkëkohore Evropiane

Temat:

- **Raportet Qeveri Qendrore - Komunë nga prizmi i Politikave Publike**
- **Roli i ministrive të linjës në raport me zhvillimin në nivelin lokal**
- **Roli i qeverisë në koordinim të veprimeve për integritet evropiane**

Prof. Dr. Ita O'Donovan, ligjëruese në Universitetin e Birminghamit dhe njëherësh eksperte e Komisionit Evropian

Në ligjërimin e saj Prof. Dr. Ita O'Donovan, me temën: marrëdhëniet në mes nivelit politik dhe shërbyesve civil, e filloj ligjërimin e saj pikërisht sipas tri komponentëve kryesore të Marrëveshjes së Madridit mbi transparencën, llogaridhënien dhe kornizën ligjore. Llogaridhënia nga institucioni për të marre një veprim, i cili veprim për duhet me qenë i drejt për të gjithë dhe ekuivalent i barabartë, i paanshëm pra neutral ku do të përfitoj institucioni apo ndonjë grup. Sipas saj qendra ka tendence të mbaj gjërat, në anën tjetër decentralizimi kërkon ti kthej gjërat me poshtë pra tek qytetari se si duhet të jetë shërbimi. Shërbimet te qytetari janë shumë të rëndësishme duhet bërë sakrificat që këto shërbime të jenë së më të gjera (shërbime) po me më pak kosto. Gjithashtu theksoj se si të bëjmë punëtoret me efektive!?. Në këtë pike, ajo theksoj parimin efektivitetit që shërbyesi civil të mendojë ndryshe esenca ka qenë në reformat të ndërmarra në Angli, Turqi, Holandë dhe vende të tjera të Evropës Perëndimore që dha shembuj poashtu edhe të Evropës Lindore dhe Qendrore të dala nga sistemi komunist, synimi ka qenë përmirësimi i shërbimeve për qytetarët. Një prej kriterëve të shërbyesve civil ka qenë arsimimi nëse këta nuk janë pajtuar me reformat në administratë mund të jenë larguar (siç thekson ja dera). Pra kryetari i komunës, ekipi i menaxhmentit kanë punuar si një ekip që organizata të jete efektive në ofrimin shërbimeve për qytetarin, gjithashtu e njëjta ka theksuar që ky ekip duhet të ketë besim në atë që do të arrij.

Gjithashtu, e njëjta theksoj shembuj nga Anglia ky kryeministri i Anglisë Toni Bler kishte theksuar se Komunitat nuk janë duke bërë punën ashtu si duhet, fjala është për kompanitë për administrim të mbeturinave, ka kërkuar nga komuna mund të jetë një kompani e përbashkët pikërisht ky reduktim i punëtoreve dhe funksionim i kompanive ka ardhur nga kriza fiskale, ku vendimet e vështira për shërbimet e qytetareve si shumë shërbime si ambienti, sociale, arsimit te prekura nga këto reforma kanë qenë punëtorët në rast se është shkarkuar apo larguar nga puna shteti i ka siguruar asistencën sociale.

Pika themelore pra zyrtari që ka marr punën me për ta zbatuar, individi përgjegjës i është kërkuar llogaridhënia kjo është një prej parimeve të BE-së është llogaridhënia, pra ne gjuhen politike është transparenca mirëpo te elementi i trete është ligjshmëria dhe zbatimi i ligjshmërisë pra ne do të ndërlidhemi me mendimin e lartpërmendur që qendra ka tendencë të mbaje më shumë fuqi ndërsa komuna kërkon të ketë më shumë kompetenca pikërisht në menaxhmin publik me të mirat publike, pikërisht për këtë Bler kishte theksuar se Komunitat nuk po punojnë si duhet pra ka kërkuar që qytetari të jetë vendimmarrje sipas Besnik Tahirit pikërisht është kriza që po shtyn për të bërë reforma.

Duke ndërlidhë me ne në Kosovë Besnik Tahiri theksoj se, reformat janë shumë të ndërlidhura (produkt), në fillim duhet me funksionu sistemi, me largu dikën nga puna menjëherë ai kthehet në rast social se shteti nuk ka mundësi të siguroj një asistencë në raste të pushimit nga puna si pasoj e reformave administrative, si pasoj plotësimit të kriterit të arsimit, mos përgjegjësisë në punë,



Ilogaridhënies apo mos zbatim të pasojave . Ne fund z.Tahiri përfundoj duke theksuar se nuk duhet mendohemi se je njeriu me i rëndësishëm, të bëhemi pjesë por ka rënë motivi përgjithësisht. Tema –II, Parimet e hapësirës administrative Evropiane, strategjitë e reforme së administratës publike në Kosovë, Elementet kyçe të proceseve reformuese në BE. Te pjesa e dytë e ligjërimit të saj prof. O’donovan u përqendruar ne atë se qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë e reformës së administratës publike:

- Ajo përbehet prej tri zotimeve me të cilat qeveria do ti shërbejë qytetaret dhe bizneset
- Të jetë efektive në ofrimin e shërbimeve administrative
- Të jetë efektive nga pikëpamja e kostos dhe
- Evropiane në organizimin dhe metodat e punës

Në këtë ligjërimit ajo filloj se, kemi një kryetar të komune, këshilltar pastaj drejtorë dhe shërbyes civil. Kryetarët dhe drejtorët janë pjesë e partisë , por veprojnë në komunë.

Balancimi i gjërave–sistemi i qeverisë komunale duhet të jete i balancuar në mes qeverisë (ekzekutivit) dhe asamblesë komunale. Gjithashtu e njëjta thekson edhe ligji që duhet për të mbajtur përgjegjësi ekzekutivin, duhet të jetë funksional pra të jetë Ilogaridhënës.

Buxheti- në formulimin e buxhetit, pra ekzekutivi e sjell në kuvend. Kjo tregoj një shembull nga vendi i saj se komuna udhëhiqet nga partia A,B,C,D. Ju jepet shërbyesve civil, partitë e vogla nuk duhet të tregojnë për planet tyre. Ne kuvend vijnë tri forma të buxhetit, pikërisht buxheti që bëhet ligje është ai që kalon 51 vota. Në Angli është një kërkesë me ligje ...ata shërbyes civil, në kuvend duhet të dëshmojnë si e kanë formuluar, shpjegojnë në detaje. Buxheti ekzekutiv duhet të kaloj në kuvend dhe duhet të ketë elementet balancuese .

Ne Angli 192 gjuhe janë folur (vende të ndryshme që kane ardhur ne Angli) e rëndësishme me i edukuar, kane te drejt me aplikua për vende pune, nëse nuk janë trajtuar drejt mund të ngritët proces gjyqësor. Shërbyesit civil e kane kryer punën që është obligim, rekrutimi është neutral, kuvendi ka të drejt qe te mbaje ekzekutivin përgjegjës. Sistemi mbështet anëtarët e kuvendit po ashtu duhet të mbështet ekzekutivin që të jetë përgjegjës (Ilogaridhënës). Fuqia e kryetarit, ndarja e fuqisë (përgjegjësive), në këtë mënyre që të ndaje informatat, të trajtohen mirë dhe të kalojnë tek partia (fton se ky lider është i mire), është politikisht e pjekur. Duhet të këtë pasoja me ekzekutivin (politik), drejtorët që nuk peformojnë si duhet por ai nuk do të jete më në atë detyrë.



Parimet e Hapësirës Administrative Evropiane janë :

1. Sundimi i ligjit: ligjshmëria besueshmëria dhe para-shikueshmëria
2. Sinqeriteti dhe transparenca
3. Përgjegjshmëria ligjore
4. Efikasiteti dhe paanshmëria

Elementet kyçe të proceseve reformuese ne BE, gjatë 20 viteve të fundit:

- Fokus më i madh në rezultatet dhe vlerat e rritur për parinë
- Delegim i kompetencave dhe fleksibilitetet i zgjeruar
- Llogaridhënie të forcuar dhe kontroll
- Orientim ndaj klientit dhe shërbimit
- Kapacitetet i forcuar për strategjinë dhe politiken e zhvillimit
- Prezantimi i konkurrencës dhe elementeve të tjera të tregut
- Marrëdhëniet korrekte me nivelet e tjera të qeverisë

Besnik Tahiri, Magjistër i Shkencave të Qeverisjes së Decentralizuar dhe Zhvillimit Ndërkombëtar

Është Nevojë që të te ndryshohet kultura, të shtohet në sistem (kontrolli dhe monitorimi) duhet të jete prezent. Trajtimi i asamblesë, është problem se janë të zgjedhur nga populli por në anën tjetër janë si përfaqësues të partive politike në kuvend, të cilët i japin llogaridhënie vetëm subjektit që i përkasin këtu është shkëputja ndërmjet qytetarit. Kur je i arsimuar, i matur po arrin me u be anëtar i partisë quhet politik e mirë e mençur. Duhet të ketë konsekuence nëse nuk ka konsekuence dhe një detyrim që ke përgjegjësi pune, nuk e bënë si duhet dhe do të ketë ngecje në disa fusha. Një sistem politik që ka mekanizmin e (kontrollit, monitorimit) dhe atë motivimit (stimulimit), është një politik e mirë. Matja e performancës bëhet jo me atë që ka kur hynë dhe del në pune po me shërbimet që ofron qytetarit.

Fatmir Haxholli, Magjistër i Studimeve Bashkëkohore Evropiane

Komunat duhet të hartojnë planin e veprimit për plotësimin e kriterëve që kërkohen për integrim apo afrim në Evropë, sipas kriterëve dhe direktivave që kërkohen të plotësohen nga UE-ja, një gjë të tillë kërkon për plotësim të këtyre kriterëve niveli qendror duke kërkuar nga pushteti lokal. Pushteti lokal duhet të nxjerrin akte e ato duhet të jene në harmoni me ligjet nacionale dhe të UE-se. U cilësua si e domosdoshme se zyra për shërbime me qytetarët duhet të jete shume dinamike ne drejtim te ofrimit sa me efikas te informacionit dhe shërbimeve për qytetarin. Komunat duhet të bëjnë këto përmirësime si:

- Ngritja e kapaciteteve njerëzore
- Pushtetet lokale nuk menaxhojnë mire me financat , me mjete publike
- Administrimi me staf të ngarkuar
- Respektim i kompetencave që niveli qendror i ka dhënë nivelit lokal (komunave)

Ligjëruesi, Haxholli theksoj se, komunat duhet të dëshmojnë me një planifikim të mirë, me dhënat lidhur për kriteret që janë kërkuar nga niveli qendror që duhet komunat me i plotësuar, por deri me tani nuk kanë afrua të dhëna të plota, statistika se deri kund kanë arrite.

Parimet:

Paanshmërisë,

Llogaridhënies,

Subsidiaritetit-me u be një pune e mire duhet të bartet ne nivel lokal ketë për te matur administratën – performance është me atë të ofrimit të shërbimit me te mire të qytetari.

VIII. Moduli i Katërt

8.1. Bashkëpunimi ndër-komunale dhe roli i asociacioneve

Vendi: Hotel Prishtina

Data: 26 mars 2013

Ligjeruesit:

Agron Maxhuni, Drejtor Ligjor MAPL

Besnik Tahiri, Magjistër i Shkencave të Qeverisjes së Decentralizuar dhe Zhvillimit Ndërkombëtar

Tema:

- **Rolin e asociacioneve në trajtimin dhe avokimit – Çështjeve që ndërlidhen me bashkëpunimin e komunave mes vete dhe me mekanizmat tjerë institucional.**
- **Bashkëpunimit ndër-komunal- mekanizmat ligjorë që mundësojnë bashkëpunimin e komunave në aspektet e përbashkëta.**
- **Prezantimi i udhërrëfyesit për bashkëpunim ndër-komunal**

Me qëllim diskutimin dhe elaborimin e fushës së “Bashkëpunimit Ndër-Komunal - BNK” në kuadër të kornizës dhe rregullativës ligjore aktuale të Republikës së Kosovës, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale në bashkëpunim me Fondacionin Friedrich Ebert të mbështetur nga Ambasada Norvegjeze po mbanë një konference një ditore me zyrtar të komunave të Kosovës, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe me përfaqësues të ftuar nga organizatave ndërkombëtare që përkrahin qeverisjen lokale në Kosovë.

Duke ditur rëndësinë e BNK, si dhe rolin e zyrtarëve të komunave në mbrojtje dhe avancim të



interesave komunale, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale nëpërmes kësaj punëtorie synon të bartë informacionin dhe njohuritë përkitazi me dobishmërinë që sjellë BNK te zyrtarët komunal si dhe të interesuarit e tjerë. Gjithashtu, në frymë të zhvillimeve të fundit, trajtimi i kësaj teme përkon edhe me angazhimin e vazhdueshëm të Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale në informon e drejtë dhe të mirëfilltë të publikut në lidhje me rëndësinë e kësaj teme, duke ndikuar kështu në depolitizimin e saj, si dhe temave tjera në kuadër të qeverisjes lokale.



Në këtë konferencë, në kuadër të prezantimeve dhe diskutimeve u theksua se akteret kryesor që pritet të forcojnë dhe intensivikojnë BNK në Kosovë nuk janë duke shfrytëzuar mundësitë që ofron kjo fushë, ndërsa kjo po rezulton më humbje të burimeve, potencialit financiar e njerëzor.

Në prezantimin e tij, z. Agron Maxhuni, Drejtor Ligjor në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal theksoi se, "legjislacioni aktual ofron mundësi të gjëra në fushën e BNK, si

në nivel vendi ashtu edhe në nivel ndërkombëtar (...) Parimi themelor për BNK është efektiviteti, dhe ekonomikiteti, ndërsa objektivat për hyrje të komunave në BNK bazohen në vullnet dhe interes të përbashkët në fushat sikurse zhvillimi socio-ekonomik, zhvillimi dhe shfrytëzimi i tokës, mbrojtja e mjedisit, planifikimi."

Drejtori Ekzekutiv i Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale theksoi se, "është për keqardhje që komunat dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës nuk po shfrytëzojnë BNK si instrument, platformë, praktike e zhvillimit lokal me qëllim mbrojtjen dhe avancimin e interesave dhe mirëqenies së qytetarëve, dhe kjo lidhet pjesërisht me humbjen e kohës së akterëve vendor në agjenda politizuese." Sipas z. Tahiri, komunat duhet të identifikojnë dhe të konkretizojnë fushat e BNK duke shfrytëzuar edhe fuqinë që kanë në bazë të kompetencave të institucioneve të vet-qeverisjes lokale, diçka që aktualisht mungon. Në këtë kuadër, z. Tahiri dhe panelsitet tjerë diskutuan edhe rolin e Asociacionit të Komunave të Komunave. Konstatimi i përbashkët në këtë drejtim është se dihet mirëfilli që roli i një Asociacioni të Komunave është trajtimi, konsultimi, promovimi i çështjeve që bien në fushëveprimin e vet-qeverisjes lokale, andaj në këtë frymë nuk duhet humbur kohe dhe energji në trajtimin e temave që dalin prej praktikave evropiane të parapara me Kartën Evropiane për Qeverisje Lokale.



**IX. Moduli i Pestë
Temat sektoriale**

9.1. Marrëdhëniet ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Komunave

Vendi: Hotel Golden

Data: 17 prill 2013

Ligjeruesit:

Mr.Sc Lulzim Fushtica, Këshilltar për Siguri në Bashkësi – ICITAP; Departamenti i Drejtësisë – SHBA

Major. Çlirim Hajdini, Policia e Kosovës

- Si të fuqizohet Sundimi i Ligjit dhe Siguria e Komunitetit në nivel lokal
- Vizitë dhe ligjëratë në Policinë e Kosovës

Mr.Sc Lulzim Fushtica, Këshilltar për Siguri në Bashkësi – ICITAP; Departamenti i Drejtësisë – SHBA

Ne ligjërimin e tij përmendi Kornizën ligjore si:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës
- Ligji për policinë
- Ligji për sigurinë dhe komunikacionin Rrugor
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri
- Ligji për Armët
- Strategjia Kombëtare për Siguri në Bashkësi
- Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Krimit
- Strategjinë e Policimit në Bashkësi
- Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi

I njëjti dha sqarimet e nevojshme për Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit për Sigurinë në Bashkësi për periudhën 2011-2016. Infrastruktura e Sigurisë në Bashkësi është si :

Niveli qendror

MPB Divizioni për Siguri në Bashkësi,
Grupi Drejtues i Strategjisë për Siguri Në Bashkësi

Niveli Komunal

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)

Niveli Lokal

Ekipet e Vepruese për Siguri në Bashkësi(EVSB)
Këshillat Lokal për Siguri Publike(KLSP)

Sipas kësaj strategjie janë themeluar forumet e sigurisë në shumicën e komunave të Kosovës, të cilat veprojnë që nga viti 2004, janë themeluar rreth 22 Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi, rreth 32 Ekipet të Veprimit të Sigurisë në Bashkësi dhe 27 Këshilla Lokal për Siguri Publike. Qëllimi kryesor është formimi i një marrëdhënie të re, mbështetja e marrëdhënies ekzistuese në mes anëtarëve të komunitetit, përfaqësuesve të komunave dhe policisë, duke zhvilluar forume për bashkëveprim dhe pjesëmarrje.



bashkëveprim dhe pjesëmarrje. Synimi është që njerëzit të cilët punojnë së bashku për një qëllim të përbashkët do të rrisin respektin dhe besimin tek njëri-tjetri duke ndërtuar themelet të forta nga të cilat mund të adresojnë çështje, brenga të përbashkëta dhe për të zgjidhur probleme lokale (vendore). Rezultati i dëshiruar i këtij bashkëveprimit të komunitetit janë zvogëlimi i krimit, përmirësimi i kushteve jetësore dhe siguria e komunitetit. Pjesëmarrëse në Këshillin Komunal të Sigurisë është kryetari i komunës, përfaqësues nga OJQ-te, mediat, arsimit,

policia, pra roli i këtij këshilli është këshillues lidhur për çështjet me të cilat ballafaqohet qytetari si adresimi i tyre në institucionet përgjegjëse, e cila ka për qëllim identifikimin dhe adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me krimin, sigurinë dhe kualitetin e jetës, për të arritur qëllimin e përbashkët, krijimin e një bashkësie më të sigurt. Një punë të mirë dhe koordinim duhet të kenë


me këtë KKSBB edhe Ekipet e Veprimit të Sigurisë në Bashkësi, ku komuniteti ka fituar beneficione të shumta duke përfshirë:

- Rritja e vetëdijes që ka të bëjë me aktivitetet e përbashkëta të komunitetit, komunës dhe policisë;
- Përmirësimi i komunikimit në mes komunitetit, komunës dhe policisë;
- Rolet të qarta për zvogëlimin e krimit dhe përmirësimin e kushteve jetësore;
- Rritja e shkathtësive për zgjidhjen e problemit;
- Vizion i qarte për të ardhmen;
- Rritja e vetëdijes që ka të bëjë me çështjet /problemet e tanishme (qetë endacak, ndotja e mjedisit, prerja e pyjeve, dëmtimi i lumenjve).



Deri më sot, financimi për projektet e sigurisë është realizuar, kryesisht nga organizata ndërkombëtare. Rreziku potencial, sipas ligjëruesit do të ishte nëse këto organizata bëjnë një tërheqje të menjëhershme dhe të paplanifikuar. Kjo do të rrezikonte në masë të madhe konceptin e sigurisë në bashkësi. Andaj financimi dhe planifikimi nga qeveria e Kosovës është i domosdoshëm. Efekti financiar i strategjisë do të mbulohet kryesisht nga buxheti i Kosovës, i lidhur dhe harmonizuar me sektorët e tjerë të

arsimit, policisë, MPB-së dhe komunave të Kosovës. Njëti theksoj partneret ndërkombëtar si ICITAP-in (Departamenti i Drejtësisë Amerikane) që ka dhënë një ndihmë të madhe në themelimin, funksionalizimin e si dhe veprimin EVSB –se (Ekipet e Sigurisë në Bashkësi), mbështetur nga OSBE-ja. OSBE-ja trajnime përveç KKSBB por me theks të veçantë për sektorin e policisë në bashkësi si policinë sektoriale Policinë e Komuniteteve si ndryshe njihet si polici i lagjes. Në përmbyllje Besnik Tahiri theksoj se, koncepti i sigurisë në Bashkësi është krijimi i një mjedisi të sigurt dhe të qetë (siguria e mirëqenës dhe sigurisë) është një hap shumë i rëndësishëm për investim për zhvillim ekonomik lokal. Këtë prezantim u përmbyll me mendimin e Henri Ford që ka arritur të krijojë linja punë duke bashkuar njerëzit përkundër dallimeve të tyre me një qëllim të përbashkët “kryerjen e punëve” i cili thekson: Bashkimi është fillim, harmonia në bashkësi është progres të punuarit së bashku është sukses.



Major Çlirim Hajdini, Policia e Kosovës- Në ligjërimin e tij dha informacionet për strukturën organizative të policisë së Kosovës ma shumë ishte përqendruar në shifra si numrin e stacioneve të policisë, nënstacioneve etj.

X. Konsultim me Kryetarët e Komunave pjesëmarrëse në Programin “Akademia për Qeverisje Lokale”

Vendi: Hotel Golden

Data: 18 prill 2013

Pjesëmarrës:

Besnik Tahiri, Drejtor ekzekutiv KLGJ

Jan Braathu, Ambasador i Norvegjisë

Besa Luzha, Koordinatore e programeve – FES

Shaip Surdulli, Kryetar i Kamenicës

Sasa Mirkovic, Kryetar i Kllkotit

Fatmir Krasniqi, Nënkryetar i Fushë Kosovë

Dibran Perçuku, Nënkryetar i Vushtrrisë

Rasim Selmanj, Kryetar Deçan

Tema:

- **Konsultimi me përfaqësuesit e komunave**
- **Evaluumi i programit – feed back nga Komunitat**



XI. Vizita studimore në Republikën e Malit të Zi dhe Kroacisë

Vendi: Republika e Malit të Zi dhe Kroacisë

Data: 24-27 prill 2013

Tema:

- **Reformat në Republikën e Malit të Zi dhe Kroacisë - sfidave dhe perspektivës së integritit evropian.**
- **Ligjeruesit / Referuesit**

Boris Milloshević, zv. Ministri i Administrimit Lokal në Republikës së Kroacisë

Jelena Pavičić - Vukičević, Nënkryetare e Zagrebit

Stjepan Kožić, Kryetar i prefekturës së Zagrebit

Edi Shtefanić, Kryetar i Qytetit të Poreçit

Përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Kroacisë

Përfaqësues të Komunës së Ulqinit

Vizitat:

Republika e Kroacisë: Ministria e Administrimit Lokal në Republikës së Kroacisë, Qyteti i Zagrebit, Prefektura e Zagrebit, Qyteti i Poreçit, Ministria e Punëve të Jashtme.

Mali i Zi: Këshilli Komunal i Ulqinit, Ekzekutivi i Komunës së Ulqinit.

Në kuadër të Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale, pjesë të projektit “Akademia për Qeverisje Lokale”, kamë qëndruan për vizitë studimore në dy shtete të rajonit – Republikën e Malit të Zi dhe Kroacisë.



Në Kroaci, u pritëm nga zv. Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Kroacisë, Boris Milloshević, nga Prefekti i Zagrebit, Stjepan Kožić, nënkryetarja e Zagrebit, znj. Jelena Pavičić Vukičević, dhe Kryetari i Poreçit Edi Shtefanić, ndërkaq në Malin e Zi nga pjesëmarrësit u pritën nga zyrtarët e Komunës së dhe disa përfaqësues të tjerë jetës parlamentare në Republikën e Malit të Zi.

Zv. Ministri Milloshević, në pritje të delegacionit nga Kosova duke shprehur vlerësimin për këtë Akademinë, theksoi rëndësinë dhe dobinë e vendosjes së një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet dy vendeve në fushën e qeverisjes lokale. Ai shprehu bindjen se qeveritë lokale të të dy vendeve mund të shkëmbejnë përvojat e tyre dhe t'i zbatojnë ato me sukses në komunat respektive, në interesin më të mirë të komuniteteve që ata drejtojnë. Qeverisja Lokale është e lidhur direkt me njerëzit dhe me veprimtarinë e tyre përmes ndikimit direkt në jetën e tyre dhe të komuniteteve në tërësi. Në kuadër të kësaj vizite studimore, ky dikaster i qeverisjes shpalosi një pasqyre të shkurte të qeverisjes lokale në Republikën e Kroacisë.

Kroacia ka një sistem tri shkallshe të qeverisjes, organizimi i qeverisjes lokale në Republikën e Kroacisë përbehet prej 155 njësive të qeverisjes lokale, ku 428 prej tyre i takojnë njësive komunale, 127 njësive lokale të qyteteve të nivelit dyte të qeverisjes dhe 21 i takojnë nivelit të tretë apo prefekturave (zhupania), këtu përfshihet edhe Zagrebin.

Kompetencat e njësive të qeverisjeve komunale janë përcaktuar me ligjet fuqi, edhe pse Kroacia ka të koncentruar pushtetin qendror një numër të madhe të kompetencave që realisht nuk flitet shumë për elemente të decentralizimit të pushtetit. Në nivel të qyteteve si njësi qeverisjes ushtrohen kompetencat në fushat e arsimit në nivel fillor dhe të mesëm, kulturës, mirëqenies sociale dhe shëndetësi primare, të ndërtimit dhe mbrojtëse civile territoriale dhe shërbimeve publike.

Gjate elaborimit të formës së organizimit të qeverisjes lokale nga përfaqësuesit e ministrisë gjegjëse, u shkoqiten disa nga problemet që reflektojnë në cilësinë e menaxhimit të qeverisjes si bllokadat e ndryshme për shkak të divergjencave në mes kryetarit të qyteteve dhe kuvendit në mos kalimin e vendimeve të kryetarit për investime të ndryshme kapitale, këto probleme reflektojnë si rezultat i sistemit të proceseve zgjedhore ku kryetari që zgjidhet direkt nga populli shpesh herë nuk e ka shumicën në kuvend të qyteteve.




Në raste të konflikteve eventuale në mes kryetarit dhe kuvendit dhe mos arritjes së konsensusit brenda periudhës kohore prej 3 muajve, atëherë qeveria qendrore fut në funksion mekanizmin e shpalljes së zgjedhjes së parakohshme për rate njësi lokale, ku instituti është karakteristik për Rep. Kroacisë, e cila këto dy organe qeverisjes kryetar dhe këshill kanë kompetenca të balancuara.

Në Prefekturën e Zagrebit u pritëm nga Prefekti i Zagrebit, Stjepan Kožić, ku ai shpjegoi rolin që luan prefektura në raport me Komunat dhe qytetet po ashtu dhe në raport me Ministrin përkatëse ai po ashtu sqaroi se prefektura rregullon qeshjet kryesisht që kanë të bëjnë me planifikim hapësinor në raport me nevojat për zhvillim, sa për informacion prefektura e Zagrebit gjatë viti fiskal ka në dispozicion një buxhet prej 40 milion euro në vit. Rëndësi të veçantë Zagrebi i ka kushtuar ambientit, ndërkaq zhvillimi ekonomik kryesisht ka të bëjë me industrinë e ushqimit që është tejet e zhvilluar, kujdes i veçantë i kushtohet dhe efijqences së energjisë elektrike, ndërkaq hov të zhvillimit ka marrë dhe industria e prodhimit të tramvajeve. Në bashkëbisedim me nënkryetaren Pavičić-Vukičević ajo theksoi rëndësinë e ofrimit të shërbimeve sociale dhe diskriminimit që u bëhet niveleve të qeverisjes lokale në këtë aspekt. U tha se reforma e pushtetit lokale shihet si proces i

vazhdueshëm dhe duhet të ndodhe si pasojë e analizës që vjen në bazë të indikatorëve dhe nevojave reale nga terreni, për mua personalisht kjo ishte mjaft e rëndësishme.

Po ashtu gjatë vizitës studimore në Kroaci, rëndësi të veçantë pat vizita në Komunën e Poreqit dhe përfaqësuesit e komitetit shqiptarë në regjionin e Isres, një pritje madhështore delegacionit të akademisë. Kryetari i Poreqit, përse afërmisht na njoftoi për rolin që luanë këto qytete bregdetare në zhvillimin ekonomik dhe turizmit në regjionin e Isres, i cili është motorë i zhvillimit të turizmit në Kroaci, për kundërshtimin se ky regjion ka vetëm 17 mijë banorë dhe me një administratë të qeverisjes lokale relativisht të vogël, arrin të gjenerojë të hyra vjetore mbi 700 milionë euro, mirëpo kryetari shprehi shqetësimin e vet se gjitha hyrat shkojnë në buxhetin e shtetit dhe vetëm 30% e tyre i kthen qytetit për të investuar në fusha të ndryshme. Ndërkaq në Ulqin, u pritëm nga zyrtarët e Komunës i cili tregoi për angazhimet e Komunës në stimulimin të turizmit dhe nevojën që në kuadër të strategjive komunale, turizmi i cilitdo lloji të futet në strategjinë e komunës. Gjatë vizitës në këtë komunë, një rëndësi të veçantë që ja vlen të theksohet është fakti se përfaqësuesit shkoqiten disa probleme që vazhdimësi ballafaqohet qeverisja lokale në Ulqin, si:



- Mungesa e ligjit për legalizimin e ndërtimeve të objekteve pa leje, ku potencuan se ekzistojnë një numër i madhë i objekteve pa leje ndërtimi, në këtë kontekst do të ketë dy refleksione në njërin anë, sikurse të aplikohen këto taksa në këtë fushë do të ketë një trendë të madh në ngritjen e hyrave vetjake dhe në anën tjetër do të ndikojë pozitivisht në ndërprerjen e ndërtimeve jashtë planeve urbanistike;
- Po ashtu përfaqësuesit lokal shprehin shqetësimin e tyre në raport me të hyrat vetjake nga të mirat detare, për faktin se nga hyrat e gjithëmbarshme që gjeneron Ulqini vetëm 20% e tyre i kthen Komunës për investime kapitale, çka do të thotë se pjesa tjetër shkon në buxhetin e shtetit, ky fenomen tregon që nuk ka elemente të decentralizimit fiskal dhe pengon zhvillimin ekonomik lokal dhe uljen e papunësisë.

Personalisht konsideroj një vizitë të frytshme dhe përvojë të mirë, duke parë për se afërmisht organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në Kroaci dhe Mal të Zi, dhe besoj që me këtë raport kam arrit të përshkruar në pika shkurta përmbajtjen e vizitës studimore.

**Moduli i Pestë
Temat sektoriale**

XII. Themelimi i komunave të reja: mundësi apo pengesë për shërbime më të mira në sistemin e qeverisjes lokale

Vendi: Swiss Diamond

Data: 4 qershor 2013

Ligjeruesit:

Basri Musmurati, Zv. Minister i MAPL-së

Besnik Tahiri, Drejtor i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale

Rizvan Sylejmani, Ish- minister i pushtetit lokal në Republikën e Maqedonisë

Rufki Suma, Kryetar i Komunës - Hani i Elezit

Sasa Mirković, Kryetar i Komunës – Klokot

Shukrie Ramadani, Zhegra

Bajrush Ibishi, Orllani

Temat:

Qasja e Qeverisë në raport me Themelimin e Komunave të reja, prezantimi i kriterëve të qeverisë për themelimin e komunave të reja,

Prezantimi i parimeve dhe kriterëve ndërkombëtare për themelimin e komunave të reja: Mundësitë dhe rreziqet

Rasti i Maqedonisë

Rasti i Kosovës

Kërkesat për themelimin e komunave të reja

Prishtinë, 4 qershor 2013: Me temë krijimin e komunave të reja Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (IQKL) në kuadër të Akademisë për Qeverisje Lokale sot u organizua konferenca një ditore. Prezantues të ftuar të kësaj konference ishin zv. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Basri Musmurati, dhe ish Ministri i Pushtetit Lokal nga Maqedonia, z. Rizvan Sulejmani. Të ftuar ishin kryetar të komunave, drejtor të departamenteve, Këshilltar të Asambleve Komunale, Me këtë rast z.



Besnik Tahiri drejtor i IQKL shpjegoi thellësisht rëndësinë që ka rregullimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë, duke përmendur faktin që “ndryshimi i kompozicionit të komunave aktuale është proces i cili duhet mbështetur në kritere të qarta dhe të paracaktuara me politika dhe legjislacion vendor, i cili reflekton edhe bazën formale ndërkombëtare si dhe praktikën e mira perëndimore”.

Në këtë kontekst në rolin të zv. Ministrin, z. Basri Musmurati theksoi që në mesin e shumë parimeve tjera “krijimi i komunave të reja nga këndvështrimi institucional duhet mbështetur në parimin e efikasitetit dhe subsidiaritetit, ndërsa si Ministri e Administrimit të Pushtetit Lokal ata kanë parasysh që secila kërkesë për krijimin të komunave të reja duhet trajtuar ndaras dhe jo në pako”. Në këtë mënyrë, në pikëpamje të zv. Ministrin zvogëlohet rreziku që rrjedh nga krijimi i një apo disa komunave pa u bazuar në kritere dhe vlerësim paraprak. Sipas z. Musmurati edhe tani në këtë kompozicion aktual të komunave “ka vështirësi në ofrimin e shërbimeve të cilat janë kryesisht me shtrirje regjionale, andaj duhet marr në konsideratë që komunat e reja duhet pasur kapacitetin për t’u vetadministruar dhe për të ofruar shërbimet e nevojshme dhe te parapara me ligj”.

Në frymë të ngjashme prezantoi edhe ish Ministri i Pushtetit Lokal në Maqedoni i cili theksoi se “krijimi i komunave të reja pa u mbështetur në analizë, kërkesë dhe pa marrë për bazë nevojën që ato të jenë qëndrueshme dhe autonome do të ishte më shumë një veprim politik dhe me rreziqe se sa një zgjidhje praktike.” Sipas tij Maqedonisë i është dashur të korrigjojë gabimin kur kishte rritur numrin e komunave, duke e zvogëluar këtë numër me një reforme jo fort të lehtë. Në këtë kuadër sipas tij Kosova nuk duhet të bëjë gabim të ngjashëm dhe të themelojë komuna pa kritere.



Në këtë takim u prezantuan qëndrimet dhe nga komunat e themeluara me procesin e decentralizimit (Juniku Kllokoti, Hani i Elezit) dhe përfaqësuesve të lokaliteteve që po synojnë të krijojnë komuna të reja (Rogova, Orllani dhe Zhegra).

**Deklarata e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale nga Konferenca:
Themelimi i Komunave të reja
Mundësi apo Pengesë për Sistemin e Qeverisjes Lokale në Kosovë**

Shpjegim: Themelimi i një apo disa komunave të reja është proces i cili duhet bazuar në kritere të qarta dhe të definuara paraprakisht. Themelimi i një apo më shumë komunave nuk është, dhe nuk do të duhej të jetë një proces i izoluar dhe arbitrar sipas parapëlqimeve të askujt, e as të qeverisë. Rregullimi i themelimit të komunave të reja siç parashihet me kriteret aktuale të ofruara në këtë dokument mundësonte procesi i themelimit të bazohet mbi parimet e respektimit të demokracisë lokale, të respektimit të autoriteteve lokale, të konsultimit të palëve të interesuara dhe prekura nga ky proces, përfshirë këtu aspekte që lidhen me të mirën e përgjithshme publike.

Praktikë e ngjashme vlen edhe për ndarjen, ndryshimin e kufijve komunal, përcaktimin e emrave apo vendbanimeve. Sipas legjislacionit në fuqi, Kosova ka një numër të komunave rregullimi i qeverisjes së të cilave mundësohet nëpërmes kushtetutës, dokumenteve ndërkombëtar (në veçanti me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale). Aktualisht ne po përballemi jo vetëm me injorimin e provizioneve ligjore, por edhe me aspektet e rregullimit demokratik i cili si bazë ka respektimin e vullnetit të qytetareve, të respektimit të institucioneve lokale, si dhe konsultimin e opinionit publik, përfshirë këtu edhe akter aktivë fushën e qeverisjes lokale në kuadër të shoqërisë civile, komunitetit të donatorëve, dhe më gjerësisht.

Në këtë kontekst, ndryshimi i një apo disa kufijve administrativ konceptohet si proces i cili bëhet nëpërmes:

- a) Bashkimin e një apo më shumë komunave brenda një komune ekzistuese;
- b) Bashkimin e dy apo më shumë distrikteve për formimin e një komune të re;
- c) Ndarjen e një pjese të një komune apo komunave për formimin e një komune të re.

Siç shihet nga ky formulim të tre këto dimensione kanë të bëjnë, dhe i referohen më shumë një nevojë apo domosdoshmërie e cila duhet të dal nga autoritetet dhe komunitetet lokale, në këtë rast nga përfaqësuesit e një apo disa komunave, dhe jo nga vendimi i komunitetit, fshatit dhe parapëlqimeve politike të përfaqësuesve në qendër.

Kjo sepse precedenti i krijimit të komunave pa kritere, dha në mungesë të parapëlqimit të përfaqësuesve dhe strukturave lokale përcjellë një mesazh krejtësisht negativ të komunat ekzistuese, dhe për më shumë krijon përshtypjen se ekzistenca dhe autoriteti i tyre janë në funksion të agjendës qendrore, duke e vendosur kështu përfaqësimin e qytetareve dhe interesave lokale në pozicion inferior.

Baza rregullative e nevojshme për krijimin e një apo disa komunave, ose thënë më mirë për çfarëdo ndryshimi të kufijve administrativ - me këtë do të duhej nënkuptuar edhe ndryshimet që dalin nga themelimi i komunave të reja - duhet të përfshijë së paku:

- a) hartën e territorit apo territoreve kufijtë administrativ të komunave të cilave janë propozuar të ndryshohen duke specifikuar kufijtë e propozuar administrativ të rinj;
- b) arsyen për domosdoshmërinë e një ndryshimi të tillë dhe efektet pozitive apo negative të qasjes së qytetarëve në shërbimet e ofruara nga komuna;
- c) një analizë e efekteve të një ndryshimi të tillë sa i përket qëndrueshmërisë ekonomike të komunës;

- d) një arsyetim që dëshmon se ndryshimet e tilla janë në përputhje me parimin e vartësisë dhe do të ketë ndikim pozitiv në ushtrimin e kompetencave komunale;
- e) materiale shpjeguese në formë të likuidimit të borxheve apo obligimeve që merren nga secila komunë;
- f) raportin që shpjegon mënyrën e konsultimeve me qytetarë, rezultatet në favor dhe kundër që burojnë nga konsultimet e tilla; dhe
- g) dokumente tjera të krijuara nga autoritetet përkatëse gjatë procesit.

Në bazë të këtyre kritereve mund të konstatohet qartazi se themelimi i krijimit të një apo më shumë komunave nuk është vetëm proces teknik, por përkundrazi është një proces i studiuar thellë dhe i cili synon ndryshimin pozitiv të një gjendje në favor të interesave të qytetareve të komunave ekzistuese, të cilat shtrojnë arsyen e krijimit të një komune të re, gjithmonë në të mirë të qytetarëve të komunave të përfshira në këtë proces.

Gjithashtu propozimi për ndarjen e një pjese të territorit, për krijimin e një komune të re duhet të përfshijë:

- a) Planin për ndarjen e pronave të tyre, të drejtave të tyre, veprimeve, borxheve dhe obligimeve;
- b) Planin për ri-caktimin e stafit komunal i cili do të emërohet në komunën e re; dhe
- c) Listën e certifikuar të qytetarëve që banojnë në atë pjesë, apo në pjesët që do të përbëjnë komunën e re.

Konstatim si konkluzion:

Themelimi i një apo disa komunave të reja duhet të jetë proces gjithëpërfshirës, transparent, dhe konsultativ, kjo në mas të madhe nuk ka ndodhur dhe nuk po ndodh aktualisht;

Themelimi i një apo disa komunave të reja është proces i bazuar në vlerësime, analiza, dokumentime, përfshirë këtu edhe aspekte që lidhen me të drejta dhe detyrime,

- Precedenti i krijimit të një komune pa këtë praktike sfidon vetëqeverisjen lokale, qëndrueshmërinë ekonomike dhe frymën demokratike të përfaqësimit lokal;
- Qeveria në bashkërendim me komunat e interesuara në ndryshimin e kufijve administrativ, në parim, mund të marr iniciativë për themelimin e një apo disa komunave të reja, por;
- Anashkalimi i komunave ekzistuese, i vullnetit dhe para së gjithash i mandatit të tyre ligjor e vendos vetëqeverisjen lokale në një pozicion të cenueshëm, dhe rrjedhimisht nuk është mesazh i mirë për këdo;
- Publiku i gjerë, shoqëria civile, komuniteti i donatorëve, si dhe të përfshirë në çështje të vetëqeverisjes lokale kanë interes t'i kontribuojnë fuqizimit të qeverisjes dhe demokracisë.
- Në këtë kuadër, mos përfshirja e tyre në tema të rëndësishme sikurse kjo është sinjal negativ dhe njëkohësisht përjashtues.

Rekomandime:

KLGI sugjeron formimin e një komisioni nga Qeveria që përfshinë ZKM, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Planifikimit dhe Shoqërinë Civile për të studiuar shqyrtimin e kushteve të komunave të reja.

Në këtë aspekt KLGI rekomandon që:

- Të paraqitet nevoja e arsyeshme për themelimin e një komune të re dhe të prezantohen efektet për qytetarët sa i përket qasjes në shërbimet e ofruara nga komuna;
- Të bëhet analiza e efekteve në raport me qëndrueshmërinë ekonomike të komunës së re;
- Të përpilohet një arsyetim i cili dëshmon se ndryshimet e tilla janë në përputhje me parimin e vartësisë dhe do të ketë ndikim pozitiv në ushtrimin e kompetencave komunale;
- Prezantimi i planit për ndarjen e pronave të tyre, të drejtave të tyre, veprimeve dhe obligimeve;
- Plani për ri-caktimin e stafit komunal i cili do të emërohet në komunën e re;
- Listën e certifikuar të qytetarëve që banojnë në atë pjesë, apo në pjesët që do të përbëjnë komunën e re.

KLGI beson se themelimi i komunave të reja duke i anashkaluar këto elemente do të shpie tek një konfuzion të konsiderueshëm në përgjithësi dhe në veçanti në skenën politike dhe elektorale si dhe do të krijon një gjendje pakënaqësie tek qytetarët.

Radio Televizioni i Kosovës: 10 ngjarje mediatike/edicioni qendror i lajmeve

Radio Televizioni 21: 10 ngjarje mediatike/edicioni qendror i lajmeve

KohaVizion: 7 ngjarje mediatike/edicioni qendror i lajmeve

Gazeta dhe portali Express: <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,15,95944>

Komuna e Bogovinës:

http://www.komunabogovine.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=1391%3Atakim-i-instituti-kosovar-per-qeverisje-lokale-ikql-me-kryetarin-e-komunes-se-bogovines&catid=114%3Aaktivitete&Itemid=68&lang=sq

Portali Gjilani Info: <http://gjilani.info/?p=1113>

Komuna e Gostivarit:

http://www.gostivari.gov.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=1380&Itemid=1

Portali 2Online:<http://2online.com/lajmet-qendrore/9252-vizite-studimore-ne-gostivar.html>

Gazeta dhe portali Epoka e Re:

<http://www.epokaere.com/PrintPreview.aspx?AID=2283&SID=12&LID=2>

Gazeta dhe portali Bota Sot:

<http://www.botasot.info/kosova/195411/si-te-funksionoj-demokracia-lokale/>

Portali Indeksonline:

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=52476>

Portali Kosovapress:

<http://kosovapress.com/?cid=1,84,159893>

Gazeta dhe portali Shekuli, Republika e Shqipërisë:

<http://shekulli.com.al/web/p.php?id=16346&kat=109>

Portali Lajme nga Shqipëria:

<http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/1047349140/titulli/Bashkepunimi-nder-komunal-po-humb-potencial-financiar-dhe-njerezor>

Gazeta dhe portali Kroat Vecernji list:

<http://www.vecernji.hr/vijesti/kosovsko-izaslanstvo-posjetilo-hrvatsku-clanak-545843>

Prefektura e Zagrebit:

http://www.zagrebackazupanija.hr/vijesti?year=2013&id=2680&fb_action_ids=10151375882671611&fb_action_types=og.likes&fb_source=aggregation&fb_aggregation_id=288381481237582

Portali Kosovatimes:

<http://kosovatimes.net/?page=1%2C17%2C29818>



Kosovo Local Government Institute

Address: Rexhep Luci, 15/6 Prishtinë, Kosovë, 10000

E-mail: klg.institute@gmail.com

Tel: +381 38 225 625 or 045-540 164

Web : www.klg-institute.org